



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 243 Akti

Nr. 351 Vendimi
Tiranë, më 25.2.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 22.2.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish- Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Maria Qirjazi**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, vëzhguesen ndërkombëtare, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në janar të vitit 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Genta Tafa (Bungo) dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e tij, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 7.5.2018, e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të

Interesave me anë të së cilës u dërgua një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

11. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke filluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë në datën 29.12.2020, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t' u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit, në datën 29.12.2020 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 14.1.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 4.2.2021.

14. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit është njohur me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, si dhe ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 17.2.2021, vendosi të ftojë znj. Maria Qirjazi në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail* në datën 17.2.2021.

15.1 Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 22.2.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

15.2 Subjekti i rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Znj. Maria Qirjazi, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësisë profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

22. Referuar vendimit Nr. 2/2017^[1], të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr.84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

^[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
 - ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Znj. Maria Qirjazi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi **** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private, si vijon: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2003; (ii) periodike/vjetore, për vitet 2004 – 2017; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

Gjyqtarja Maria Qirjazi ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 14.6.1988 dhe më 1.7.1994, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe më pas më 27.4.2000, emërohet gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastër. Gjyqtarja Maria Qirjazi ka kryer funksionin e kryetares së Gjykatës së Apelit Gjirokastër për periudhën 21.4.2008 – 16.7.2013. Në datën 16.7.2013 subjekti Maria Qirjazi është dekretuar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*;

- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; dhe
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, pas:

- a. shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, me nr. indeksi ****, datë 23.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b. krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2017, në raport me të dhënat e “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”;
- c. shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç. të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisionit.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting* të dorëzuar në ILDKPKI subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto pasuri:

1. Apartament 2+1, rruga “***”, Tiranë, blerë në vitin 2008**

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 1.1** Subjekti i rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, ka deklaruar se zotëron një apartament 2+1 në rrugën “*****”, p. **, ap. **, Tiranë. Kjo pasuri e paluajtshme është blerë me kontratën e shitblerjes të datës 4.12.2008. Vlera: 5,000,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.
- 1.2** Pagesa për këtë pasuri është deklaruar si e bërë në vitet 2003 – 2004. Burimi i kësaj pasurie është deklaruar me të ardhurat nga dhënia për ndërtim e truallit me sip. 345 m², në Zonën ****_****, Sarandë, me kontratën e sipërmarrjes nr. ****/****, datë 12.11.2003, duke përfituar si vlerë takuese shumë prej 3,000,000 lekësh, si dhe të ardhura familjare.
- 1.3** Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratat vjetore periodike ndër vite:
 - Në deklaratën e interesave private “Para fillimit të detyrës 2003” – blerë apartament me burim nga shitja e një trualli për ndërtim në Sarandë (truall i blerë nga shteti), plus të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat. Gjithashtu, ka deklaruar dhe detyrim në vlerën 700,000 lekë ndaj shoqërisë “*****” sh.p.k. për blerjen e apartamentit.
 - Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2004, shlyerje detyrimi në vlerën 700,000 lekë, ndaj shoqërisë “*****” sh.p.k. për blerje apartamenti.
- 1.4** Për këtë pasuri është lëshuar fillimisht certifikata për vërtetim pronësie nr. ****, datë 2.12.2008, shoqëruar me kartelën për pasurinë apartament me sip. 143 m², nr. **/****, vol. ****, f. ****, z. k. ****, Tiranë, në pronësi të shoqërisë “*****” sh.p.k.”.
- 1.5** Me kontratën e shitjes nr. ****/****, datë 4.12.2008, shoqëria e ndërtimit “*****” sh.p.k. i ka shitur subjektit të rivlerësimit pasurinë apartament me sip.143 m², në Tiranë. Çmimi

i shitjes është përcaktuar në shumën 5,000,000 lekë, shumë e cila rezultoi sipas kontratës se është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale (më 28.2.2004).

1.6 Gjatë hetimit rezultoi se detyrimi për blerjen e kësaj pasurie në shumën prej 5,000,000 lekësh, është shlyer plotësisht nga subjekti i rivlerësimit deri në datën 28.2.2004¹.

1.7 Subjekti ka deklaruar se si burim për blerjen e apartamentit, ka shërbyer:

- kontrata e sipërmarrjes nr. *****/****, datë 12.11.2003, për vënien në dispozicion të palës investitore truallin me sip. 345 m² dhe prej këtij veprimi ka përfitur vlerën 3,000,000 lekë, si kompensim të dhënies së këtij trualli;
- vlera prej 1,300,000 lekësh, e paguar në vitin 2003, është deklaruar si burim nga të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti privat;
- vlera prej 700,000 lekësh, e paguar në fillim të vitit 2004, si burim nga likuiditetet e subjektit dhe bashkëshortit.

1.8 Gjatë hetimit rezultoi se është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. *****/****, datë 12.11.2003, me palë investitore A. Sh, ku porosites rezultoi bashkëshorti i subjektit. Objekti i kontratës së sipërmarrjes është vënia në dispozicion të palës investitore trualli me sip. 345 m² në pronësi të bashkëshortit të subjektit, ndodhur në Sarandë dhe pala investitore merr përsipër ndërtimin “apartamente ndërtimi” nga 2-5 kate. Sipas kësaj kontrate dhe marrëveshjes është rënë dakord midis palëve se për ndërtimin që do të realizohet bashkëshorti i subjektit do të marrë një apartament banimi me sip. 110 m² dhe si kompensim të apartamentit vlerën prej 3,000,000 lekësh.

1.9 Për këtë shkëmbim bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka marrë prej palës investitore vlerën në lekë të apartamentit të banimit si kompensim të dhënies së truallit me sip. 345 m², në shumën prej 3,000,000 lekësh dhe nuk ka më pretendime pronësie ndaj pasurisë “truall”, të cilën ia kaloi në administrim palës investitore.

1.10 Pasurinë truall me sip. 345 m², rezultoi se bashkëshorti i subjektit e ka blerë me kontratën e shitblerjes nr. *****/****, datë 4.11.2002, me palë shitëse Bashkia Sarandë dhe palë blerëse shtetasin V. Q, pasuri e cila ndodhet në Zonën *****, *****, të qytetit të Sarandës dhe destinacioni ishte përcaktuar për ndërtim hoteli. Vlera e blerjes së kësaj pasurie truall me sip. 345 m² në vitin 2002, rezultoi në shumën prej 166,000 lekësh.

1.11 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se shtetasi V.Q. ka të regjistruar veprimet për pasuritë e paluajtshme në Sarandë, si vijon:

- *Aktshkëmbim pasurie të paluajtshme, datë 26.8.2010, ndërmjet bashkëshortit të subjektit, si pronar i truallit me sip. 345 m² dhe investitorëve A. Sh., D. Sh., B. H. (përfaqësuar nga A. Ç.). Në emër të investitorëve rezulton e regjistruar pasuria nr. *****/****godinë, në Zonën *****, *****, Sarandë, objekt “lokal dhe banesë” 5 kate, me sipërfaqe ndërtimi 183 m², ky objekt rezultoi i ndërtuar në truallin me sip. 354m² në pronësi të bashkëshortit të subjektit.*
- *Vërtetim hipotekore lëshuar në datën 26.8.2010, në emër të shtetasve A. Sh., D. Sh. dhe B. H. ku figuron e regjistruar pasuria nr. *****/****, me sip. 183m² në adresën Zona *****, *****. Kjo pasuri rezulton me barrë hipotekore, ku theksohet se është i vlefshëm vetëm për kryerje të kontratës së shkëmbimit me pronarin e truallit bashkëshortin e subjektit.*

¹ Bazuar në statement e “A** Bank”, vërtetohet kalimi i shumës 11,400 euro për shoqërinë “*****” sh.p.k. Pjesa tjetër është deklaruar nga subjekti si pagesë e bërë cash.

- 1.12** Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, sipas deklarimit të subjektit vlera prej 4,300,000 lekësh (3,000,000 +1,300,000 lekë) është paguar në vitin 2003 dhe diferenca prej 700,000 lekësh është paguar në vitin 2004.
- 1.13** Për pagesën e kryer në vitin 2003, subjekti ka deklaruar se vlera prej 3,000,000 lekësh është nga të ardhurat e përfituara nga shkëmbimi i pasurisë truall me sip. 345 m², blerë më parë nga Bashkia Sarandë në vitin 2002, në shumën prej 166,000 lekësh. Ky deklarim i subjektit përkon me vlerën e kontratës së shkëmbimit.
- 1.14** Diferenca prej 1,300,000 lekësh, e paguar në vitin 2003, është deklaruar si burim nga të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti privat.
- 1.15** Por për këto të ardhura, që kanë shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie, si dhe veprimet e kryera, ndër vite, Komisioni ka konstatuar disa problematika të cilat i ka referuar në pikën 1.17, në vijim të këtij vendimi.
- 1.16** Lidhur me gjetjet e konstatuara nga Komisionit, gjatë fazës së hetimit të kryer për këtë pasuri, është pyetur subjekti i rivlerësimit për të paraqitur dokumentacion provues lidhur me kohën dhe mënyrën e përfitimit të shumës prej 3,000,000 lekësh nga investitorët A.Sh., etj., si dhe të deklarojë burimin e shumës prej 700,000 lekësh, të paguar shoqërisë në datën 28.2.2004, si shpenzim i kryer për këstin e fundit për blerjen e pasurisë apartament.
- 1.17** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3², subjekti ka deklaruar, si vijon:

*“Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *****/****, datë 12.11.2003, për vënien në dispozicion të palës investitore sipërfaqen e truallit prej 345 m², kemi përfituar shumën prej 3,000,000 lekësh si kompensim në vlerë të pjesës takuese nga ndërtimi që do të realizohej. Kjo shumë, sikurse pasqyrohet edhe në kontratën noteriale të sipërcituar, është marrë nga ana jonë cash jashtë zyrës noteriale dhe të dyja palët nuk kishim asnjë pretendim.*

*Deklaroj se burim i shumës prej 700,000 lekësh, paguar shoqërisë ‘*****’ sh.p.k., në datën 28.2.2004, si kësti i fundit për blerjen e pasurisë apartament 2+1, në Tiranë, ka qenë depozita bankare në ‘A** Bank’ në vlerën prej 6,400 euro e mbartur ndër vite.*

*Në fund të vitit 2003, siç kam deklaruar dhe më parë, gjendja cash në banesë ka qenë në vlerën 900,000 lekë. Nga gjendja cash e fundvitit 2003, kemi depozituar në ‘ALPHA Bank’ në datën 6.1.2004, shumën 5,000 euro. Në datën 25.2.2004 i kemi paguar shoqërisë ‘*****’ sh.p.k. shumën 11,400 euro, nga të cilat shuma prej 700,000 lekësh (=5.400 euro) ishte për këstin e fundit të blerjes së apartamentit, si më lart, dhe shuma 6.000 euro ishte parapagim për blerje të një garazhi nga kjo shoqëri. Por, në vijim nuk u realizua blerja e garazhi, dhe kjo shumë na u kthye cash nga administratori i shoqërisë ‘*****’ sh.p.k., më 25.7.2004.*

*Bashkëngjitur: gjendja dhe transferta nga llogaria jonë në ‘A** Bank’ për llogari të shoqërisë ‘*****’ sh.p.k.; deklaratë e administratorit të shoqërisë ‘*****’ sh.p.k., datë 25.7.2004”.*

- 1.18** Nga Komisioni, pas përgjigjes së subjektit, u konstatuan se:

- i. Shuma prej 11,400 euro e paguar kundrejt shoqërisë “*****” sh.p.k., përbëhet nga një vlerë ekzistuese prej 6,400 euro në “A** Bank” të subjektit dhe një derdhje të bërë në datën 6.1.2004, në vlerën 5,000 euro.

² Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, të dërguar nga subjekti në dosjen e Komisionit.

- ii. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike kursime *cash* në fund të vitit 2003, kështu që nuk vërtetohet burimi i derdhjes së shumës prej 5,000 euro, datë 6.1.2004, në llogarinë në “A** Bank”.
- iii. Lidhur me pagesën e dytë bazuar në transaksionin e kryer në “A** Bank”, rezultoi një transfertë bankare në datën 26.2.2004, në shumën totale prej 11,400 euro, në favor të shoqërisë “*****” sh.p.k.
- iv. Ndërkohë, duket se subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të pagesës së vlerës prej 11,400 euro, të kryer në vitin 2004. Në fakt, vlera 6,400 euro ishte gjendje në llogarinë në “A** Bank”, krijuar ndër vite. Referuar analizën financiare³ subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e depozitës bankare në shumën 6,400 euro.
- v. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimi nuk ka provuar as burimin e ligjshëm të depozitimit të shumës prej 5,000 euro në janar të vitit 2004.
- vi. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se, në datën 25.2.2004 i ka paguar shoqërisë “*****” sh.p.k., shumën 11,400 euro, nga të cilat shuma prej 700,000 lekë (=5,400 euro) ishte për këstin e fundit të blerjes së apartamentit, si më lart, dhe shuma 6,000 euro ishte parapagim për blerje të një garazhi nga kjo shoqëri. Në vijim nuk u realizua blerja e garazhit dhe kjo shumë u kthye *cash* nga administratori i shoqërisë “*****” sh.p.k., në datën 25.7.2004.
- vii. Ky shpenzim nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004 të paraqitur pranë ILDKPKI-së dhe nuk përkon me deklarinimin e subjektit që në vitin 2004, ka paguar shumën e mbetur prej 700,000 lekësh.
- viii. Subjekti, pasi është pyetur për këtë pagesë, ka deklaruar se: *“Në janar 2004 ne kemi bërë një marrëveshje verbale me shoqërinë ‘*****’ sh.p.k., për blerjen e një garazhi në shumën 6,000 euro, duke bërë pagesën më 28.2.2004, me transfertë bankare së bashku me vlerën e papaguar të çmimit të apartamentit. Për shkak se marrëveshja për blerjen e garazhit nuk ishte realizuar, më 25 korrik 2004 shuma prej 6,000 euro na u kthye nga administratori i shoqërisë, duke bërë një deklaratë të thjeshtë midis nesh. Shuma e kthyer u përdor pjesërisht për blerjen e automjetit tip ‘Ford’, pasi automjeti tjetër tip ‘Volkswagen’ u shit më vonë. Pjesa tjetër, së bashku me shumën e fituar nga shitja e automjetit tjetër, janë mbajtur cash në banesë. Kjo shumë nuk ishte deklaruar në DPV-në e vitit 2004, pasi ishte një veprim i kryer brenda atij viti, si pagesa ashtu edhe kthimi i saj”*⁴.
- ix. Për të provuar këtë deklarinim, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë jonoteriale pa datë të regjistruar, për kthimin e shumës prej 6,000 euro, në *cash* nga administratori i shoqërisë, por që nuk provohet kthimi bazuar në një dokument ligjor provues të kohës. Këto të ardhura prej 6,000 euro, të cilat subjekti i ka deklaruar për blerje pasurie të luajtshme, më pas, nuk janë përfshirë në analizën financiare të hartuar nga Komisioni, sepse nuk u vërtetua burimi i ligjshëm i tyre.
- x. Për këtë pretendim, subjekti nuk arriti të provojë që shuma prej 6,000 euro ishte dhënë për blerjen e garazhit dhe aq më tepër që nuk vërtetohet kthimi i pretenduar i saj prej shoqërisë “*****” sh.p.k.

³ Shihni analizën financiare për vitet 1994 – 2003.

⁴ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

- xi. Lidhur me pagesën e bërë për likuidimin e një pjesë të detyrimit, sipas analizës financiare⁵ të bërë për periudhën deri në vitin 2003, subjekti nuk ka pasur mundësi të paguajë pjesën e parë të këstit për blerjen e kësaj pasurie në këtë vit, në vlerën 4,300,000 lekë.
- xii. Në këtë analizë financiare Komisioni nuk ka përfshirë dhe vlerën e pretenduar të përfituar nga subjekti me kontratën e shkëmbimit, datë 12.11.2003, për vënien në dispozicion të palës investitore truallin me sip. 345 m² (përfituar shuma 3,000,000 lekë), si kompensim në vlerë të pjesës takuese nga ndërtimi që do të realizohej. Kjo shumë, sikurse pasqyrohet edhe në kontratën noteriale të sipërcituar, është marrë prej subjektit *cash* dhe jashtë zyrës noteriale. Për këto të ardhura (3,000,000 lekë) subjekti nuk ka paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit. Forma e kontratës nuk është kontratë shkëmbimi (referuar dispozitave të kodit civil).
- xiii. Nisur nga fakti i realizimit të kontratës së shkëmbimit të truallit me vlerë monetare subjekti ka shmangur edhe detyrimet që rrjedhin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat në buxhetin e shtetit.
- xiv. Në momentin e shkëmbimit të truallit, bashkëshorti i subjektit nuk ka disponuar certifikatë pronësie lidhur me truallin me sip. 345 m², por vetëm vërtetim nga dokumentet hipotekore lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë në datën 26.11.2002. Edhe pas lidhjes së kontratës së shkëmbimit në datën 12.11.2003 me investitorët shtetasit A. Sh., etj., nuk ishte lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë truall. Për më tepër, bashkëshorti i subjektit për këtë pasuri është pajisur përsëri me vërtetim hipotekor lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë në datën 26.8.2010, pasi kontrata e sipërmarrjes me investitorët A. Sh. etj., , ishte deklaruar si e ezauruar.
- xv. Lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë së pasurisë truall me sip. 345 m², në Sarandë, (pasuri e cila ka shërbyer si burim kryesor për krijimin e pasurisë apartament), Komisioni konstatoi disa problematika të trajtuara në vijim.
- xvi. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitblerjes së datës 4.11.2002, më palë shitëse Bashkinë Sarandë. Objekti i kontratës së shitjes është ndërtimi i një hoteli nga bashkëshorti i subjektit. Me vendimin datë 14.9.1999, të Bashkisë Sarandë, z.V.Q. i është dhënë leje shesh ndërtimi si investitor dhe brenda një afati të caktuar duhet të paraqitej dhe kërkesa për leje ndërtimi. Nuk shpjegohet nga subjekti si i është dhënë nga Bashkia Sarandë një sipërfaqe toke truall për ndërtim bashkëshortit të saj, pa pasur një rregullim ligjor lidhur me pronësinë e tokës truall, statusin, si dhe mbi të drejtat e tij mbi këtë pasuri (pasi shitja e kësaj pasurie është bërë në vitin 2002). Bazuar në planimetrinë e sheshit të ndërtimit bashkëshorti i subjektit do të ndërtonte një objekt 2-3 kate. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti dhe që disponohet në dosjen e Komisionit nuk është përcaktuar vlera e këtij investimi dhe as burimi me të cilën do ndërtohej ky objekt. Leja e ndërtimit është lëshuar nga KRRT-ja e Bashkisë Sarandë në datën 29.10.2002, ku përcaktohet ndërtimi i një hoteli me financim të z. V. Q.. Në datën 19.7.2002 është mbajtur dhe procesverbali i piketimit të objektit (para lidhjes së kontratës së shitblerjes së truallit dhe para dhënies së lejes së ndërtimit), ku bashkëshorti i subjektit ka firmosur fillimin e punimeve si pronar i pasurisë truall me sip. 345 m².
- xvii. Për sa më sipër, bashkëshorti i subjektit ka përfituar një pasuri me anë të kontratës së shitjes në vitin 2002, por ka kryer veprime ligjore duke u hequr si pronar i saj disa vite më përpara. Bashkëshorti i subjektit ka përfituar pronë (tokë truall) nga

⁵ Referojuni analizës financiare te “rezultatet e hetimit”, dërguar subjektit.

Bashkia Sarandë për ta ndërtuar dhe zhvilluar vetë dhe më pas i ka kaluar këto të drejta te personat e tretë (investitorët A. Sh., etj.). Mënyra e kalimit të të drejtave me anë të kontratës së sipërmarrjes nuk është në formën e duhur ligjore sipas Kodit Civil, kjo pasi subjekti akoma nuk ishte pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë truall me sip. 345 m². Mënyra e përfitimit të pronësisë është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, kjo e deklaruar edhe nga zyra e pasurive të paluajtshme, por edhe nga gjetjet e konstatuara nga Komisioni mbi pasurinë “apartament me sip. 21 m², Sarandë”, trajtuar në vijim të këtij vendimi. Sipas shkresës nr. **** prot., datë 7.1.2009, të ZQRPP-së Sarandë, rezultoi se shitja e truallit me sip. 345 m² mbi të cilën është kryer investimi, nuk figuron të jetë regjistruar paraprakisht në regjistrat e pasurive të paluajtshme, çka e bën këtë kontratë të paregjistrueshme, pasi nuk përbën titull pronësie të detyrueshëm në kuptim të ligjit.

xviii. Në përfundim rezultoi se subjekti nuk ka shpjeguar pse është përfituar kjo pronë truall, si është përfituar, me çfarë statusi i është dhënë nga bashkia, vlerën e investimit që do të kryente, burimin e ligjshëm dhe pse ka transferuar të drejtat e përfituara te një palë e tretë.

1.19 Bazuar në analizën financiare, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi që të paguajnë vlerën prej 4,300,000 lekësh në vitin 2003, të blejnë pasuri të tjera, të rrisin likuiditetin, si dhe të kryejnë shpenzimet e periudhës 1994 – 2003. Në këtë analizë financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga shkëmbimi i truallit në vitin 2003, në vlerën 3,000,000 lekë. Nuk është marrë parasysh gjendja *cash* në vlerën 900,000 lekë në fund të vitit 2003, e cila është deklaruar së pari në pyetësor. Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për vitet 1994 – 2003, janë trajtuar në vijim (te rubrika metodologjia).

1.20 Lidhur me pagesën e bërë në vitin 2004 (ku sipas deklaramentit të subjektit kishte mbetur për t’u paguar vlera 700,000 lekë), sipas statementit të llogarisë në emër të z. V. Q. dhe znj. M. V. tek “A** Bank”, në datën 25.2.2004, rezultoi transferta e bërë në vlerën 11,400 euro, drejt shoqërisë “*****” sh.p.k. Kjo shumë është përfshirë në analizën financiare për vitin 2004.

1.21 Bazuar në analizën financiare⁶ rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nga data 1.1.2004 – 28.2.2004, kanë realizuar të ardhura në shumën 319,091 lekë. Për rrjedhojë, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e shumës prej 700,000 lekësh, shumë e cila ka shërbyer për shlyerjen e pagesës së fundit për blerjen e kësaj pasurie.

1.22 Konkluzion i Komisionit në përfundim të hetimit të kryer.

a) Lidhur me burimin e blerjes së pasurisë apartament

- Burimi kryesor i blerjes së pasurisë apartament kanë qenë të ardhurat e deklaruar nga shkëmbimi i kryer mbi truallin me sip. 345 m², në vlerën 3,000,000 lekë.
- Lidhur me burimin e të ardhurave nga kontrata e sipërmarrjes së datës 12.11.2003, në vlerën 3,000,000 lekë, subjekti nuk ka paraqitur prova se këto burime janë të ligjshme dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore të zbatueshme mbi këto të ardhura. Forma e kontratës së shkëmbimit nuk është sipas formës dhe përmbajtës së përcaktuar nga Kodi Civil dhe se kjo formë shkëmbimi duket që ka sjellë shmangie edhe të detyrimeve fiskale në buxhetin e shtetit.

⁶ Referojuni analizës financiare te “rezultatet e hetimit”, dërguar subjektit ku janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit për dy muajt e parë të vitit 2004.

- Fitimi i pronësisë truall me sip. 345 m², në vitin 2002, nga subjekti dhe bashkëshorti, është kryer në shkelje ligjore dhe me anë të veprimeve të parregullta.
- Nga subjekti dhe bashkëshorti është disponuar pasuria truall disa vite para se të lidhej kontrata e blerjes së truallit nga Bashkia Sarandë, duke kryer veprime ligjore dhe duke u sjell si pronarë të pasurisë truall pa përfituar ende të drejta ligjore.
- Subjekti nuk arriti të shpjegojë mënyrën e fitimit të pronësisë së pasurisë truall pronë publike me sip. 345 m² nga Bashkia Sarandë.
- Pasuria truall është blerë nga Bashkia Sarandë në vitin 2002, në dukje favorizuese, në shumën 166,000 lekë dhe është shitur me qëllime fitimi në shumën 3,000,000 lekë, gjë e cila lindi dyshimin e Komisionit se është bërë nga subjekti duke shfrytëzuar edhe pozitën e saj si gjyqtare.
- Qëllimi i fitimit të pasurisë truall ka qenë kryerja e investimit nga subjekti dhe bashkëshorti për ndërtim hoteli 2-3 kate. Nga subjekti nuk është deklaruar asnjëherë as në deklaratat periodike vjetore se si do të kryhej ky investim dhe burimet e ligjshme për të. Subjekti ka përfituar nga bashkia truallin për investim dhe pastaj e ka tjetërsuar te investitorët A. Sh., etj., duke ndryshuar qëllimin dhe destinacionin për të cilën është përfituar trualli dhe investimi që do të kryhej.
- Subjekti dhe bashkëshorti kanë kryer veprime për tjetërsimin e truallit pa u pajisur me certifikatë pronësie lidhur me pasurinë truall me sip. 345 m².
- Lidhur me burimin për pagesën e këstit të dytë në vlerën 700,000 lekë, subjekti ka pasaktësi në deklaratat dhe pamundësi burimesh financiare. Subjekti nuk arriti të provojë se kësti i paguar në vitin 2004, në shumën prej 11,400 euro, ka qenë një pjesë për shlyerjen e detyrimit të mbetur prej 700,000 lekësh ndaj palës shitëse dhe diferenca prej 6,000 euro ka qenë si pagesë për blerje garazhi. Subjekti nuk provoi kthimin e shumës së pretenduar prej 6,000 euro nga shoqëria “*****” sh.p.k. dhe nuk i ka deklaruar këto veprime juridike dhe financiare në deklaratën periodike vjetore.
- Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e shumës 5,000 euro, si depozitë bankare në datën 6.1.2004 (shumë nga e cila është krijuar e gjithë depozita prej 11,400 euro).

b) Lidhur me blerjen e pasurisë apartament

- Çmimi i blerjes së kësaj pasurie nuk përputhet me çmimin e referencës të tregut të lirë, të hartuar nga EKB-ja në këtë zonë kadastrale. Nëse i referohemi udhëzimit përkatës, lidhur me koston e ndërtimit në tregun e lirë për vitin 2004, vlera e pasurisë apartament me sip.143 m², në Tiranë, llogaritet në shumën 7,643,350 lekë.
- Sipas analizës financiare⁷ subjekti nuk ka pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

1.23 Për të gjitha gjetjet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

1.24 Në përgjigje të rezultateve subjekti deklaroi⁸: *“Trualli i blerë nga bashkia nuk është aspak favorizues; trualli është përfituar nga bashkëshorti për ushtrim aktiviteti tregtar; bashkëshorti para përfitimit të truallit ka kryer veprime administrative; pas transferimit*

⁷ Referojuni analizës financiare te “rezultatet e hetimit”, dërguar subjektit.

⁸ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

në Tiranë lidhëm kontratën e sipërmarrjes në vitin 2003, ku për nevoja familjare, ramë dakord që pjesën takuese sipas kontratës ta merrnim në vlerë për të blerë shtëpi në qytetin e Tiranës; forma e kontratës është përcaktuar si sipërmarrje por me elementë të përzier; fakti i moslëshimit të certifikatës së pronësisë nuk përbënte asnjë pengesë ligjore për lidhjen e kësaj kontrate; shuma e përfituar nga kjo kontratë sipërmarrje në vlerën 3,000,000 lekë është marrë cash; në vitin 2010 u lidh kontrata e shkëmbimit me investitorët; nuk i jemi shmangur pagimit të detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit; nisur nga fakti se trualli akoma nuk është regjistruar në emër të blerësit nuk kishim si të paguanim detyrimet në buxhetin e shtetit”.

1.25 Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit duke përfshirë të ardhurat e deklaruar të bashkëshortit me një normë fitimi prej 50% të xhiros vjetore (referojuni në vijim te metodologjia). Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare si vijon.

1.26 Subjekti nuk provoi pretendimin për krijimin e gjendjes *cash* në vitin 2003 në shumën prej 900,000 lekësh. Komisioni konstatoi që subjekti nuk e ka deklaruar shumën e pretenduar prej 900,000 lekësh në deklaratën periodike për vitin 2003 dhe as ndryshimin (zvogëlimin) e gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2004. Kjo shumë nuk është përfshirë nga Komisioni në analizën financiare, si burim i ligjshëm për krijimin e pasurive të deklaruar nga subjekti.

1.27 Analiza financiare për vitet 1994 – 2003

Përshkrimi	1994 - 2003
PASURI	8,611,914
Apartament 1+1 me sip. 51.3 m ² , Sarandë, M.+ V. Q., 1997 - 2010	1,307,400
Truall me sip. 387 m ² , te *****, Sarandë - Maria Qirjazi - 100% - 185.760 lekë - 1998	185,760
Magazinë në ****, D**(objekt 1 dhomë + truall me sip. 77 m ²) – V. Q. - 2000 - 2013	85,000
Truall me sip. 2,156 m ² , në ****, D** - V. Q. - 50% - 691.300 lekë - 2001	689,920
Apartament 2+1, me sip. 143 m ² , në rr. *****, Tiranë - 100% - 5,000,000 lekë	5,000,000
Truall me sip. 345 m ² , te Zona e ****, ****, Sarandë - 100% - 166.000 lekë - 2002	166,000
Autoveturë tip “Volkswagen” - 50%	324,400
Gjendje “A** Bank”	853,434
DETYRIME	700,000
Detyrim për apartament në rrugën “*****”	700,000
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	7,911,914
TË ARDHURA dokumentuar	13,075,069
Të ardhura nga puna subjekti Maria Qirjazi	4,087,834
Të ardhura nga puna bashkëshorti V. Q.	8,437,235
Të ardhura nga shitja e apartamentit Elbasan në vitin 1998	550,000
SHPENZIME	4,439,232
Shpenzime jetese	4,119,232
Shpenzime qiraje Gjirokastër periudha 2000 – 2013	320,000

Analiza dokumentuar	723,923
---------------------	---------

1.28 Analiza financiare e pasurisë apartament rruga “*****”

Të ardhura nga kontrata e sipërmarrjes datë 12.11.2003	0
Të ardhura nga aktiviteti privat V. Q.	1 300 000
Kursime te depozita në “A** Bank”	700 000
Totali i burimeve	2 000 000
Apartament rruga “*****”	5 000 000
Pamundësia financiare	-3 000 000

1.29 Në përfundim Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e të gjitha gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës.

1.30 Për këtë pasuri rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e shumave prej 3,000,000 lekësh dhe 11,400 euro. Me anë të formës së kontratës së sipërmarrjes (por duke përfituar vetëm vlera monetare) janë kryer veprime duke shmangur detyrimet financiare në buxhetin e shtetit, si dhe janë kryer veprime që cenojnë figurën e saj si gjyqtare.

2. Truall në fshatin ****, D**, blerë në vitin 2002

2.1 ILDKPKI-ja për këtë pasuri ka deklaruar: “*Fshehje në deklaratat e interesave private ‘Para fillimit të detyrës 2003’ deri në ‘Periodik/Vjetor 2016’, të pasurisë truall me sip. 2156 m², paguar vlera 689,920 lekë, në fshatin ****, D**, me vendimin nr. ****, datë 28.9.2001, të Këshillit të Komunës ****.*”

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.2 Subjekti ka deklaruar se ka bërë pagesën për blerjen e një sipërfaqe trualli në fshatin ****, D**, në datën 18.10.2002, në bazë të vendimit nr. 51, datë 28.9.2001, të ish-Këshillit të Komunës ****. Për këtë pasuri nuk rezulton ndonjë kontratë shitblerjeje e lidhur pranë noterit dhe nuk rezulton si pasuri e regjistruar. Burimi është deklaruar nga të ardhurat familjare të akumuluar. Vlera e pasurisë rezultoi në shumën 689,920 lekë.

2.3 Për këtë pasuri rezultoi vendimi nr. *****, datë 3.3.2002, i ish-Komunës ****, për dhënie leje për shesh ndërtimi me sip. 2156 m², në emër të bashkëshortit të subjektit.

2.4 Në Bankën e Kursimeve rezultoi veprim i kryer nga bashkëshorti i subjektit për kalimin e vlerës prej 690,000 lekësh, për Komunën ****, datë 18.10.2002.

2.5 ZVRPP-ja Sarandë⁹ nuk konfirmoi truall në ish-Komunën ****, D***, në emër të bashkëshortit të subjektit.

2.6 Komisioni për këtë pasuri pas konstatimeve i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte dhe të provonte: (i) mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, si dhe qëllimin e përfitimit; burimin e krijimit të të ardhurave familjare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie; (ii) përdorimin e këtij trualli që nga koha e blerjes deri më sot, duke specifikuar për çdo vit; (iii) të sqarojë si është mundësuar marrja e lejes për shesh ndërtimi disa muaj përpara se të lidhej kontrata e blerjes, si dhe para se të paguhej detyrimi financiar për blerjen e kësaj pasuri; (iv) të vërë në dispozicion një kopje të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie; (v) të japë

⁹ Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Sarandë në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

sqarime pse nuk është deklaruar kjo pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003.

2.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹⁰ subjekti deklaroi:

*“Pasuria truall në fshatin ****, D***, i është dhënë bashkëshortit tim me vendim nr. **, datë 28.9.2001, të Këshillit të Komunës ****, si shesh ndërtimi. Qëllimi i përfitimit nga ana e bashkëshortit ka qenë kryerja në të ardhmen të një ndërtimi në fshatin e tij të lindjes, ****, D***.*

*Për pagimin si çmim blerje të kësaj pasurie janë përdorur të ardhura nga gjendja e akumuluar e kursimeve familjare nga unë dhe bashkëshorti im. Kështu duke filluar nga viti 1991, bashkëshorti im kishte sjell cash kursime prej 3.000.000 lireta nga bursa e tij e studimit në Universitetin Politeknik ****- Itali, të ardhura dhe kursime nga emigracioni ynë në Greqi në vitet 1992-1994 në shumën 2.500.000 dhrahmi, paga ime ndër vite, si dhe të ardhura nga aktiviteti privat, person fizik, i bashkëshortit tim nga korriku i vitit 1994 e në vijim. Lidhur me kursimet 2.500.000 dhrahmi, të depozituara në NBG në Greqi dhe të sjella cash në vitin 1994, nga interesimi ynë atje, sot nuk ekzistojnë të dhënat e atyre viteve.*

Ky truall që nga koha e dhënies së sheshit dhe pagesës e deri më sot nuk është përdorur dhe nuk mund të përdorej për asnjë funksion, nisur nga pozicioni në kodër dhe pa rrugë kalimi ende.

*Sqaroj se nuk kemi marrë leje ndërtimi, por vetëm vendimin e Këshillit të Komunës **** ‘Për dhënie sheshi, dhe është paguar detyrimi financiar për këtë pasuri, pasi në bazë të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, ‘Për urbanistikën’ dhe rregullores së ndërtimit në zbatim të tij, vendimi i dhënies së sheshit i paraprinte çdo procedure tjetër.*

*Ju vë në dispozicion kopje të Vendimit të Këshillit të Komunes **** ‘Për dhënie shesh ndërtimi’, nr. ****, datë 28.9.2001, mandatpagesën në shumën 689,920 lekë për llogari të Komunës, por nuk kemi lidhur kontratë noteriale të shitblerjes së kësaj pasurie ende edhe sot dhe, për rrjedhojë, as nuk është regjistruar në Regjistrat e Pasurive të Paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë.*

Nuk e kam deklaruar këtë pasuri në deklaratën e parë në vitin 2003, pasi ende nuk kishim fituar të drejta reale mbi atë. Kemi qenë në pritje të lidhjes së kontratës noteriale të shitjes, apo të Vendimit ‘Për dhënie leje ndërtimi’, duke mos fituar kështu ende të drejtën e pronësisë. Por, këto procedura prej vitesh janë bllokuar duke mos fituar kështu ende të drejtën e pronësisë.

*Po ju vë në dispozicion Vendimin e Këshillit të Komunës **** për dhënie shesh ndërtimi, nr. **, datë 28.9.2001, si dhe mandatpagesën e datës 18.10.2002, në shumën 689,920 lekë, ndërsa nuk kemi lidhur ende kontratën e shitjes.*

*Lidhur me të ardhurat familjare të përdorura për blerjen e kësaj pasurie ju vë në dispozicion dokumente provuese që disponoj. Kam ri-kërkuar të dhëna nga Drejtoritë Tatimore Sarandë-D** dhe Gjirokastër, për të ardhurat e bashkëshortit tim si person fizik nga viti 1994 e në vijim, por përveç Drejtorisë Tatimore Gjirokastër që me dërgoi të dhënat për vitin 2001, ende nuk më është kthyer përgjigje nga ato të Sarandë- D**.*

Të dhënat e pagës sime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Sarandë, sipas vërtetimit të lëshuar nga ajo gjykatë nuk figurojnë të plota, për shkak të djegies së gjykatës në ngjarjet e marsit të vitit 1997. Mbi kërkesën time drejtuar ZABGj-së, kam marrë të dhëna mbi pagën e gjyqtarit të shkallës së parë në ato vite.

¹⁰ Shihni përgjigjet me e-mail të subjektit të datës 22 dhe 24 maj 2020.

Bashkëngjitur ju paraqes akte provuese¹¹”.

2.8 Bazuar në formularin nr. ** të ish-Komunës ****, datë 3.3.2002, bashkëshortit të subjektit z. V. Q., i është dhënë sheshi i ndërtimit me sipërfaqe 2,156 m² me qëllim ndërtimin e një objekti me numër kate mbi tokë 2+1. Ky formular është lëshuar bazuar në vendimin nr. ****, datë 28.9.2001, të ish-Këshillit të Komunës ****, në bazë të kërkesës së bërë nga bashkëshorti i subjektit.

2.9 Në fund të formularit për dhënien e sheshit të ndërtimit theksohet se duhet të bëhet kërkesa për leje ndërtimi në të kundërt vendimi për dhënien e sheshit të ndërtimit anulohet.

2.10 Nga momenti i marrjes së lejes për shesh ndërtimi deri më sot nuk rezultoi të jetë bërë aplikim për leje ndërtimi, për të përfunduar qëllimin e marrjes së lejes së sheshit dhe ndërtimit të objektit.

2.11 Analiza financiare për periudhën 1994 – 2003

- Sipas kësaj analize financiare, subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2002 dhe të pasurive të tjera, si dhe mbulimin e shpenzimeve të kësaj periudhe¹².
- Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet 1995 – 2004, janë trajtuar në vijim të vendimit.

2.12 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:

- a) Ngelet i dyshimtë fakti i dhënies se lejes për shesh ndërtimi bashkëshortit të subjektit disa muaj para se të paguante detyrimin për blerjen e kësaj pasurie. Ndërkohë, mungon dhe kontrata për shitblerjen e pasurisë truell nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Subjekti nuk ka deklaruar pse nuk e ka lidhur kontratën e shitblerjes deri më sot, pse nuk e ka regjistruar këtë pasuri ende në ZVRPP, si dhe nëse janë paguar detyrimet në buxhetin e shtetit që lindin nga përfitimi i kësaj pasurie.
- b) Subjekti ka përfituar këtë pasuri me qëllim investimin (ndërtim objekti), por nuk ka kryer më pas asnjë veprim për të përfunduar qëllimin (investimin) mbi të cilin ka përfituar dhe këtë pasuri.
- c) Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave private “Para fillimit të detyrës 2003” dhe deri në deklaratën periodike/vjetore 2016, pasurinë truell me sip. 2156 m², për të cilën është paguar vlera 689,920 lekë, në fshatin ****, D***.
- ç) Subjekti duhet të provojë mundësinë financiare për blerjen e pasurisë.

2.13 Për të gjitha gjetjet e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

2.14 Në përgjigje të rezultateve subjekti¹³ deklaroi:

- *Përfitimi i kësaj pasurie ka qenë me qëllim kryerjen në të ardhmen të një ndërtimi në fshatin e lindjes së bashkëshortit.*
- *Ky truell është paguar në vitin 2002, por nuk kemi lidhur kontratë shitje deri më sot, për shkak të bllokimit të procedurave nga ZVRPP.*

¹¹ Shihni dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

¹² Shihni analizën financiare për vitet 1994 – 2003, të dërguar subjektit në rezultatet e hetimit

¹³ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

- Në vitin 2002 nuk është dhënë leje ndërtimi por leje sheshi dhe nuk është deklaruar në DPV-në e vitin 2003 për shkak të paqartësisë në deklaram.
- Nuk kam pasur qëllim fshehjen e pasurisë, pasi nuk kishim përfituar titull pronësie.
- Kam pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2002 me burime të ligjshme.

2.15 Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve lidhur me të ardhurat e bashkëshortit (referojuni analizës përfundimtare të Komisionit për periudhën 1994 – 2003¹⁴). Në analizë u përfshinë të ardhurat e bashkëshortit në masën 50% të xhiros së aktivitetit privat për periudhën 1994 – 2003. Bazuar në analizën financiare, subjekti rezultoi në mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie dhe pasurive të tjera, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të kësaj periudhe.

2.16 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka deklaruar këtë pasuri dhe vlerën e blerjes së saj në deklaratën e pasurisë të vitit 2003.

3. Lokal shërbimi në Sarandë, blerë në vitin 2007

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.1 Subjekti ka blerë një lokal shërbimi në Sarandë, me kontratën nr. *****/****, datë 21.5.2007, në vlerën prej 1,980,000 lekësh. Blerja e kësaj pasurie është deklaruar me burim nga përfitimi i të ardhurave sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *****/****, datë 2.5.2006, për dhënien për ndërtim të truallit me sip. 387 m², Zona “*****”, Sarandë.

3.2 Vlera e kësaj pasurie rezultoi e shlyer jashtë zyrës noteriale në momentin e lidhjes së kontratës së shitblerjes.

3.3 Për këtë pasuri të paluajtshme rezultoi kontratë shitblerje nr. *****/****, datë 21.5.2007, me palë shitëse T. Q. dhe palë blerëse bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Pasuria është një objekt “lokal shërbimi” me sipërfaqe ndërtimi 32 m², ndodhur në Sarandë, lagjja nr. **, z. k. ****. Vlera sipas kontratës rezultoi 1,980,000 lekë.

3.4 Kjo pasuri është konfirmuar edhe nga ZVRPP-ja Sarandë, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, objekt “lokal shërbimi nr. 2”, me sipërfaqe ndërtimi 32 m², ndodhur në Sarandë, lagjja nr. **, z. K ****, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. **, datë 30.11.2006.

3.5 Burimi i krijimit për këtë pasuri, sipas deklaramit, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga kontrata e sipërmarrje, datë 2.5.2006, për ndërtim objekti me palë sipërmarrëse K. Gj. Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e pronarit të truallit me sip. 387 m², Blloku “*****”, Sarandë, ka vënë në dispozicion të investitorit dhe sipërmarrësit të drejtën reale të pronësisë, këtë truall. Me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes subjekti është likuiduar nga sipërmarrësi në shumën 1,850,000 lekë, për vlerën e pjesës që i takon si pronare e truallit. Pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes palët kanë rënë dakord dhe nuk kanë asnjë pretendim pronësie mbi truallin objekte kontrate.

3.6 Pasuria me sip. 387 m² rezultoi e blerë me kontratën e shitjes nr. ***/***, datë 3.3.1998, me palë shitëse ish-Këshilli i Rrethit Sarandë dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit në vlerën prej 185,760 lekësh.

¹⁴ Shihni analizën financiare në pikën 1. 25 të këtij vendimi.

3.7 ZVRP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar veprimet për pasuritë e paluajtshme në Sarandë, si vijon:

- *Pasuri e llojit truall me sip. 387 m², përfituar në bazë të kontratës së shitblerjes. Për këtë pasuri rezultoi kontratë shitje, datë 3.3.1998, me palë shitëse Seksioni i Financës pranë Këshillit të Rrethit Sarandë dhe palë blerëse Maria Qirjazi, kundrejt vlerës 185,760 lekë; me vendimin nr. **, datë 15.3.1990, të Këshillit Bashkiak, i jepet subjektit të rivlerësimit si investitor i sheshit të ndërtimit blloku “*****”, parcela nr. ****, me sip. 387 m² duke respektuar kondicionet e dhëna për këtë leje.*
- *Kontratë sipërmarrje (për ndërtim objekti,) datë 2.5.2006, me palë pronare të truallit subjektin e rivlerësimit dhe palë sipërmarrëse K. Gj.. Subjekti i rivlerësimit me cilësinë e pronarit të truallit prej 387 m² të ndodhur në Sarandë, Blloku “*****”, ka vënë në dispozicion të sipërmarrësit të drejtën reale të pronësisë dhe me nënshkrimin e kontratës është likuiduar nga investitori në shumën 1,850,000 lekë.*
- *Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme, datë 12.4.2017, me palë shitëse Maria Q. Q. dhe palë blerëse K. J. Gj. të pasurisë “truall” me sipërfaqe 387 m² me nr. pasurie ***/**, Sarandë. Palët janë vënë në dijeni se kartelën e pasurisë në seksionin **, për pronën është përshkruar se me Urdhrin nr. **, datë 3.4.2017, të regjistruarit, vendoset masa e kufizimit, por që palët deklarojnë se japin pëlqimin për kalimin e pronësisë nga subjekti i rivlerësimit të blerësi dhe blerësi pranon njëkohësisht që të mbartet kufizimi i mësipërm në kartelën e pasurisë pas regjistrimit të pasurisë në pronësi të tij në ZVRPP Sarandë. Palët deklarojnë se subjekti i rivlerësimit këtë pasuri ja shet blerësit kundrejt çmimit në shumën totale 1,850,000 lekë, që përkon me çmimin e pasurisë të përcaktuar nga palët në kontratën e sipërmarrjes nr. ***/**, datë 2 maj 2006. Për sa i përket likuidimit të çmimit të pasurisë në shumën 1,850,000 lekë, palët deklarojnë se kjo shumë është likuiduar plotësisht në datën 2 maj 2006 para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësjë zhvishet nga e drejta e pronësisë mbi këtë pasuri dhe pronar i ligjshëm dhe i vetëm bëhet blerësi K. Gj., (jep pëlqimin për shitjen e këtij trualli dhe b/shorti i shitësit V. Q.).*
- *Me urdhrin nr. ****, datë 3.4.2017, të ZVRPP-së Sarandë, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin nga hipoteka në sistem, urdhërohet të bëhen veprimet përkatëse për regjistrimin e kësaj pasurie dhe të vendoset masa e kufizimit mbi këtë pasuri.*

3.8 DPPPP-ja ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit ka raportime të kontratës noteriale se në datën 12.4.2017 ka shitur truall me çmim të deklaruar në vlerën 1,850,000 lekë, me palë blerëse shtetasin K. Gj..

3.9 Këtë pasuri dhe të ardhurat e përfituara nga shitja, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, të dorëzuar në ILDKPKI.

3.10 Bazuar në deklaratimet e subjektit, burim për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e përfituara nga kontrata e shkëmbimit të truallit në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj në vlerën prej 1,850,000 lekësh në vitin 2006 (me palë sipërmarrëse K. Gj.), kurse pasuria është blerë në vlerën prej 1,980,000 lekësh. Subjekti ka përfituar të ardhura nga kontrata e shkëmbimit në datën 2.5.2006, në vlerën 1,850,000 lekë.

3.11 Për këto të ardhura të përfituara nga shkëmbimi në vlerën 1,850,000 lekë, nuk rezultoi që subjekti të këtë paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit. Forma e kontratës është kontratë e mirëfilltë shitjeje sesa kontratë shkëmbimi (referuar dispozitave të Kodit Civil). Nisur nga fakti i realizimit të kontratës së shkëmbimit të truallit me vlerë monetare subjekti ka shmangur edhe detyrimet që rrjedhin për pagimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

3.12 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti shumën e përfituar në vitin 2006, në vlerën 1,850,000 lekë, nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* dhe as si shtim likuiditeti në bankë, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 të dorëzuar në ILDKPKI.

3.13 Komisioni pyeti subjektin me anë të pyetësorit nr. 2, për të:

- deklaruar përdorimin dhe mbajtjen prej saj të shumës 1,850,000 lekë nga data 2.5.2006, deri në kohën e blerjes së kësaj pasurie më 21.5.2007;
- paraqitur prova mbi burimin e financimit të kësaj pasurie, duke përfshirë kontratën e shitjes së truallit dhe prova për pagesën e blerjes së pasurisë.

3.14 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi:

*“Të ardhurat prej 1,850,000 lekësh, të përfituara nga kontrata e sipërmarrjes e datës 2.5.2006, janë deklaruar si të ardhura për vitin 2006, por nuk kam përcaktuar gjendjen *cash* të tyre nga pakujdesia apo paqartësia në plotësimin e formularit të deklaratës, i cili në vitet 2006 dhe 2007 nuk pasqyronte qartë zërin ‘likuiditete’, sikurse në formularët e viteve në vijim.*

*Kjo vlerë është deklaruar nga ana ime si shtesë pasurie për vitin 2006 dhe është mbajtur gjendje *cash* dhe mbartur në vitin 2007. Në vitin 2007 shuma prej 1,850,000 lekësh, duke shtuar edhe diferencën 130,000 lekë është përdorur për blerje pasurie ‘lokal shërbimi’ në vlerën prej 1,980,000 lekësh.*

*Sipas kontratës së sipërmarrjes datë 21.5.2007, pasqyrohet fakti se jam shlyer në vlerën e sipërcituar si çmim sendi. Pagesa është kryer *cash* para lidhjes së kontratës, përcaktuar në vetë përmbajtjen e kontratës, pa asnjë pretendim nga palët. Ky fakt vërtetohet edhe nga kontrata përfundimtare e shitjes e lidhur në datën 12.4.2017. Po kështu edhe pagesa për blerjen e pasurisë ‘lokal shërbimi’ në vitin 2007 është bërë *cash* nga të ardhurat sa më lart dhe nuk kemi mbajtur shkresa pagese, veçse kontratat noteriale.*

*Bashkëngjitur ju paraqes këto akte: (1) kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep; (2) kontratë të shitblerjes ****/****”.*

3.15 Subjekti, në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, nuk ka deklaruar gjendje *cash* në shumën e deklaruar prej 1,850,000 lekësh, për blerjen e kësaj pasurie.

3.16 Ka mospërputhje në deklarimin e subjektit, pasi vlera e blerjes së pasurisë “lokal shërbimi” është deklaruar në shumën 1,980,000, ku burim për blerjen e saj kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shkëmbimi i truallit me sip. 387 m², por vlera e këtij shkëmbimi të truallit rezultoi në shumën 1,850,000 lekë.

3.17 Në analizën financiare për këtë pasuri nuk është përfshirë vlera e përfituar nga subjekti me anë të kontratës së shkëmbimit të datës 2.5.2006, për vënien në dispozicion të palës investitore sipërfaqen e truallit prej 387 m², përfituar shuma 1,850,000 lekë, si kompensim në vlerë të pjesës përfituese nga ndërtimi që do të realizohej. Kjo shumë, sikurse pasqyrohet edhe në kontratën noteriale të sipërcituar, është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

3.18 Për këto të ardhura prej 1,850,000 lekësh, subjekti nuk ka paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit. Forma e kontratës nuk është kontratë shkëmbimi (referuar dispozitave të Kodit Civil).

3.19 Nisur nga fakti i realizimit të kontratës së shkëmbimit të truallit me vlerë monetare subjekti ka shmangur edhe detyrimet që rrjedhin për pagimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

- 3.20** Në momentin e shkëmbimit të truallit bashkëshorti i subjektit nuk ka disponuar certifikatë pronësie lidhur me truallin me sip. 387 m², por vetëm vërtetim nga dokumentet hipotekore, lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë, datë 2.5.2006. Edhe pas lidhjes së kontratës së shkëmbimit në datën 2.5.2006 nuk ishte lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë truall. Për më tepër, subjekti dhe bashkëshorti, për këtë pasuri truall, janë pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie të lëshuar nga ZVRPP-ja Sarandë në datën 3.4.2017, pra, duke bërë veprime dhe duke u hequr si pronarë shumë vite pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe pas deklarimit për likuidimin e palëve nga shkëmbimi.
- 3.21** Lidhur me mënyrën e fitimit të pronësisë së pasurisë truall me sip. 387 m² në Sarandë, Komisioni konstatoi disa problematika. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitjes së datës 3.3.1998, me palë shitëse Bashkinë Sarandë. Objekti i kontratës së shitjes dhe përfitimit të pasurisë truall është ndërtimi e një banese nga subjekti dhe bashkëshorti.
- 3.22** Me vendimin nr.113, të Bashkisë Sarandë, subjektit të rivlerësimit i është dhënë leje sheshi ndërtimi si investitore dhe brenda një afati të caktuar duhet të paraqitet edhe kërkesa për leje ndërtimi. Ky vendim bazohet në vendimin e mëparshëm të Bashkisë Sarandë të datës 15.3.1998. Nuk është sqaruar nga subjekti si i është dhënë nga kjo bashki një sipërfaqe toke truall për ndërtim, me qëllim ndërtim banese, si dhe kushtet e kriteret e përfitimit. Bazuar në planimetrinë e sheshit të ndërtimit, subjekti, mbi këtë truall, duhej të ndërtonte një objekt 2-3 kate. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti dhe që disponohet në dosjen e Komisionit, nuk është përcaktuar vlera e këtij investimi që do të kryhej dhe as burimi me të cilin do të ndërtohej ky objekt. Leja e ndërtimit nuk rezulton e lëshuar ende edhe sot nga KRRT-ja Sarandë. Subjekti, pas përfitimit të pasurisë truall, nuk ka ndjekur procedurat ligjore për të realizuar dhe finalizuar qëllimin e përfitimit të kësaj pasurie truall.
- 3.23** Për sa më sipër, rezultoi se subjekti ka përfituar një pasuri me kontratën e shitjes në vitin 1998, por nuk ka kryer veprime më pas sipas kushteve të përfitimit të kësaj pasurie. Subjekti ka përfituar pronë (tokë truall) nga Bashkia Sarandë për ta ndërtuar dhe zhvilluar personalisht dhe, më pas, ka kaluar këto të drejta te personat e tretë (te subjekti “K. Gj.”). Mënyra e kalimit të të drejtave me kontratën e sipërmarrjes nuk është në formën e duhur ligjore sipas Kodit Civil, kjo edhe pasi subjekti ende nuk ishte pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë truall me sip. 387 m².
- 3.24** Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka shpjeguar pse është përfituar kjo pronë truall, si është përfituar, me çfarë statusi i është dhënë nga bashkia, vlerën e investimit që do të kryente dhe burimin e ligjshëm dhe pse i ka transferuar më pas të drejtat e përfituara një pale të tretë.
- 3.25** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konstatimin (për të cilin iu kalua dhe barra e provës):
- a. Lidhur me burimin e blerjes së pasurisë së paluajtshme “lokal shërbimi”**
- Burimi kryesor i blerjes së kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e deklaruara nga shkëmbimi i kryer mbi truallin me sip. 387 m², në vlerën 1,850,000 lekë.
 - Lidhur me burimin e të ardhurave nga kontrata e sipërmarrjes së datës 2.5.2006, në vlerën 1,850,000 lekë, subjekti nuk ka paraqitur prova se këto burime janë të ligjshme dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore të zbatueshme mbi këto të ardhura. Forma e kontratës së shkëmbimit nuk është sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar nga Kodi Civil dhe kjo formë shkëmbimi ka sjellë shmangie edhe të detyrimeve fiskale në buxhetin e shtetit.

- Nga mënyra e fitimit të pronësisë së pasurisë truall me sip. 387 m², në vitin 1998, duket e pashpjegueshme dhe e pasqarueshme se si një gjyqtare ka përfituar këtë pasuri nga bashkia (pasuri të paluajtshme të përfituara në mënyrë të përsëritur).
- Pasuria truall është blerë nga Bashkia Sarandë në vitin 1998 për ndërtim banese në shumën 185,760 lekë dhe është shitur nga subjekti, më pas, me qëllime fitimi në shumën 1,850,000 lekë.
- Qëllimi i fitimit të pasurisë truall ka qenë kryerja e investimit nga subjekti për ndërtim banese 2-3 kate. Nga subjekti nuk është deklaruar asnjëherë se si do të kryhej investimi dhe burimet e ligjshme për të. Subjekti ka përfituar nga bashkia truallin për investim dhe pastaj e ka tjetërsuar te subjekti “K. Gj.”, duke ndryshuar qëllimin dhe destinacionin për të cilin është përfituar trualli dhe investimi që do të kryhej.
- Subjekti dhe bashkëshorti kanë kryer veprime për tjetërsimin e truallit pa u pajisur me certifikatë pronësie lidhur me pasurinë truall me sip. 387 m².

b. Lidhur me blerjen e pasurisë lokal shërbimi

- Subjekti nuk ka deklaruar mbajtjen (shtimin) e gjendjes *cash* në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, në vlerën prej 1,850,000 lekësh. Meqenëse subjekti nuk e ka deklaruar shtimin e gjendjes *cash* në vitin 2006, në analizën financiare nuk janë marrë parasysh këto të ardhura si burim për blerjen e kësaj pasurie. Bazuar në këtë vlerësim, subjekti rezultoi në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie (shihni analizën financiare në vijim për vitin 2007).
- Subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin për blerjen e pasurisë “lokal shërbimi”, pasi të ardhurat e përfituara nga shkëmbimi i truallit me sip. prej 387 m² kanë qenë në vlerën 1,850,000 lekë, kurse lokali i shërbimit është blerë në vlerën 1,980,000 lekë.
- Lidhur me burimin e të ardhurave nga kontrata e sipërmarrjes së datës 2.5.2006, në vlerën 1,850,000 lekë, subjekti nuk ka paraqitur prova se këto burime janë të ligjshme dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore të zbatueshme mbi këto të ardhura. Forma e kontratës së shkëmbimit nuk është sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar nga Kodi Civil dhe kjo formë shkëmbimi e zgjedhur ka sjellë shmangie edhe të detyrimeve fiskale në buxhetin e shtetit.
- Bazuar në analizën financiare të hartuar nga Komisioni rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

3.26 Për të gjitha gjetjet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

3.27 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵ subjekti deklaroi:

“Blerja e kësaj pasurie është bërë me burime të ligjshme nga të ardhurat e përfituara nga kontrata e sipërmarrjes në vitin 2006, të pasurisë truall të blerë nga bashkia.

Vlerën e përfituar nga kontrata e sipërmarrjes prej 1,850,000 lekësh nuk e kam deklaruar si gjendje cash në DPV-në e vitit 2006, për shkak të një gabimi në plotësim të deklaratës.

Nuk kemi pasur si qëllim shmangien e detyrimeve në buxhetin e shtetit.

Në vitin 2017 është bërë rivlerësimi i pronës dhe është paguar detyrimi për vlerën e rivlerësimit.

¹⁵ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Trualli është blera nga bashkia me qëllim ndërtim shtëpi banimi”.

3.28 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe me anë të formës së kontratës së sipërmarrjes (por duke përfituar vetëm vlera monetare) janë shmangur detyrimet financiare në buxhetin e shtetit, si dhe ka kryer veprime që cenojnë figurën e saj si gjyqtare.

4. Automjet tip “Benz”, blerë në vitin 2009

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.1 Subjekti ka deklaruar se ka blerë një automjet tip “Benz” me kontratën nr. *****/****, datë 27.3.2009. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare të akumuluar. Vlera: 900,000 lekë.

4.2 Gjatë hetimit rezultoi se bashkëshorti i subjektit me kontratën e shitblerjes nr. *****/***, datë 27.3.2009, ka blerë automjetin tip “Benz”, nga pala shitëse J.D.. Vlera për blerjen e kësaj pasurie rezultoi në shumën 900,000 lekë. Automjeti është tip “*****”, me nr. shasie ***** , me targa *****.

4.3 Ky automjet rezultoi i zhdoganuar në Doganën Durrës, datë 1.11.2008, me vlerë zhdoganimi 402,695 lekë kryer nga pala shitëse.

4.4 DPSHTRr-ja ka konfirmuar se në pronësi të shtetasit V.Q. figuron automjeti me targa *****, regjistruar në DRSHTRR Gjirokastër, bazuar në kontratën e shitblerjes së datës 27.3.2009, në vlerën 900,000 lekë.

4.5 Blerja e kësaj pasurie është deklaruar dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009.

4.6 Pas pyetjes nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar:

*“ Për blerjen e pasurisë tip automjet në vitin 2009, në vlerën 900,000 lekë, burimi kanë qenë të ardhurat familjare të depozituara në ‘A** Bank’.*

*Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009 nuk është deklaruar burimi, por ka qenë nga tërheqja e depozitës bankare në ‘A** Bank’, prej 8,000 euro, tërhequr dhe përdorur një pjesë e saj për blerje automjeti shuma 900,000 lekë (=6.500 euro).*

*Bashkëngjitur ju paraqes të dhëna bankare mbi tërheqjen 8,000 euro nga llogaria në ‘A** Bank’.*

4.7 Rezultoi se subjekti ka pasur llogari depozite në “A** Bank” në shumën 8,000 euro. Kjo është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit në datën 25.3.2009. Shuma rezulton e tërhequr dy ditë para lidhjes së kontratës për blerjen e pasurisë automjet.

4.8 Në datën e tërheqjes së shumës prej 8,000 euro nga llogaria në “A** Bank”, gjendja në llogari ishte në vlerën 8,415 euro. Burimi i kësaj vlere janë depozitime të kryera, ndër vite, nga subjekti ose bashkëshorti. Njëri depozitim në vlerën prej 5,000 euro është kryer në datën 10.11.2006, ndërsa depozitimi tjetër në vlerën prej 3,000 euro është bërë më 3.10.2008.

4.9 Subjekti është pyetur për burimin e depozitimit në vlerën 5,000 euro, tek “A** Bank” dhe, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, përgjigjet: *“Shuma prej 5,000 euro e depozituar në datën 10.11.2006 ishte nga kursimet familjare”.*

4.10 Rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e këtij depozitimi, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera deri në datën 10.11.2006.

- 4.11** Në analizë financiare nuk janë marrë parasysh të ardhurat e përfituara nga shkëmbimi në vitin 2006, në vlerën 1,850,000 lekë, pasi Komisioni nuk i ka konstatuar si burime të ligjshme.
- 4.12** Subjekti është pyetur për burimin e depozitimit në vlerën prej 3,000 euro, tek “A** Bank” dhe, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka deklaruar: *“Shuma prej 3,000 euro, e depozituar në datën 3.10.2008, sikurse kam sqaruar në DPV-në e vitit 2008, ka qenë nga kursimet familjare të atij viti.”*
- 4.13** Subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e këtij depozitimi, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera deri në datën 3.10.2008.
- 4.14** Nuk u provua burimi i ligjshëm i krijimit të depozitës me shumë 5,000 euro, si dhe nuk provohet burimi i ligjshëm i shumës totale prej 8,000 euro, të tërhequr më 25.3.2009.
- 4.15** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.
- 4.16** Për gjetjet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- 4.17** Në përgjigje të rezultateve¹⁶ subjekti deklaroi: *“Kam pasur burime të ligjshme për të krijuar depozitat bankare, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie; bashkëshorti ka përfitur nga kompania ku ishte ortak shumë prej 4,700 euro; si dhe të dyja shumat prej 5,000 dhe 3,000 euro kanë pasur burime të ligjshme të krijimit nga të ardhurat familjare”.*
- 4.18** Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit duke përfshirë të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit me një normë fitimi prej 50% të xhiros vjetore (shihni në vijim te metodologjia). Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare si vijon.
- 4.19** Analiza e mundësisë së depozitimit në shumën 5,000 euro, datë 10.11.2006

Të ardhura për periudhën 1.1.2006 – 10.11.2006, subjekti Maria Qirjazi	976,398
Të ardhura për periudhën 1.1.2006 – 10.11.2006, bashkëshorti V. Q.	971,668
Të ardhura totale	1,948,066
Shpenzime jetese deri më 10.11.2006	383,450
Shpenzime qiraje deri më 10.11.2006	88,000
Shpenzime shlyerje kredie në “S** G** Albania”	183,396
Shpenzime totale	654,846
Ndryshimi i likuiditetit 1.1.2006 – 10.11.2006	633,208
Mundësi kursimi në lekë	660,012
Mundësi kursimi në euro	5,335.46

- 4.20** Analiza e mundësisë së depozitimit në shumën 3,000 euro, datë 3.10.2008

¹⁶ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Të ardhura 1.1.2008 – 3.10.2008, subjekti Maria Qirjazi	911,254
Të ardhura 1.1.2008 – 3.10.2008, bashkëshorti V. Q.	637,500
Të ardhura totale	1,548,754
Shpenzime jetese deri më 3.10.2008	239,085
Shpenzime qiraje deri më 3.10.2008	87,000
Shpenzime arsimit + qira fëmijët Greqi deri më 3.10.2008	268,538
Shpenzime udhëtimit deri më 3.10.2008	211,233
Shpenzime totale	805,856
Ndryshimi i likuiditetit 1.1.2008 – 3.10.2008	718,412
Mundësi kursimi në lekë	24,485
Mundësi kursimi në euro	199

4.21 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe ka burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

5. Sipërfaqe trualli në Sarandë, blerë në vitin 2005

4.1 ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- *Fshehje të vendimit nr. ***, datë 28.12.2005, të Këshillit Bashkiak Sarandë për truallin me sip. 400 m², në Sarandë, në deklaratat e interesave private periodike vjetore 2005 – 2009.*
- *Deklaruar në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2010, si pagesë trualli për blerje shesh ndërtimi në Bashkinë Sarandë, në vlerën 120,000 lekë.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.2 Subjekti ka deklaruar se vlera për blerjen e kësaj pasurie është në shumën 120,000 lekë. Për këtë pasuri rezultojnë e pa lidhur ende kontrata noteriale dhe nuk është e regjistruar. Burim për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat familjare, pagat dhe kursimet.

5.3 Bazuar në vendimin nr. ***, datë 28.12.2005, të Këshillit Bashkiak Sarandë, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka bërë pagesën e një sipërfaqeje trualli në bashkëpronësi nga ½ pjesë (në bashkëpronësi të shtetasve V. Q. dhe M. Q.), datë 11.11.2010.

5.4 Bazuar në vendimet nr. ***, datë 28.12.2005 dhe nr. ***, datë 15.3.1996, të Këshillit Bashkiak Sarandë, sipas studimit urbanistik të miratuar i jepet z. V. Q. + M. Q., si investitor i sheshit të ndërtimit, blloku në vendin *****, parcela me sip. 400 m².

5.5 Me shkresën e datës 24.5.2006, të Bashkisë Sarandë, është bërë vlerësimi i truallit me sip. 400 m², në vlerën prej 240,000 lekësh.

5.6 Me mandatpagesën e datës 11.11.2010 të BKT-së, rezultuan veprime financiare në favor të bashkisë nga bashkëshorti i subjektit në shumën 240,000 lekë.

5.7 ZVRPP-ja Sarandë¹⁷ nuk konfirmon pasurinë truall të përfituar nga vendimi i këshillit bashkiak nga bashkëshorti i subjektit.

5.8 Komisioni, nisur nga fakti se në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar *sipërfaqe trualli në Sarandë, blerë në vitin 2005, në vlerën 120,000 lekë* dhe burimi për blerjen e kësaj pasurie është deklaruar nga të ardhurat familjare, nga pagat dhe kursime, i kërkoi subjektit të deklaronte:

- *pse nuk është deklaruar kjo pasuri në deklaratën periodike të vitit 2005;*
- *pse i është shitur kjo pasuri bashkëshortit, qëllimi i shitjes dhe përfitimit, pasi së bashku dhe me bashkëshortin kanë blerë dhe më parë pasuri truall nga bashkia;*
- *sa ka qenë vlera totale e paguar për këtë pasuri, burimi i saj, si dhe pse rezulton se bashkëshorti ka paguar nëpërmjet BKT-së, për llogari të bashkisë, vlerën prej 240,000 lekësh;*
- *të sqarojë nëse bashkëpronari i ka rimbursuar ndonjë pjesë të pagesës që kanë bërë, pasi pagesa që kanë bërë duket se ka të bëjë me të gjithë pronën, përfshirë pjesën e tij. Nëse po, të sqarojnë modalitetet e rimbursimit dhe të sigurojnë prova;*
- *të sqarojë kur është përfituar trualli dhe pse pagesa është bërë vetëm në vitin 2010;*
- *të sqarojë se si është përdorur trualli nga koha e blerjes së saj deri më tani, duke specifikuar vit pas viti.*

5.9 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

“Lidhur me sipërfaqen e truallit në Sarandë, për të cilën kemi paguar pjesën takuese në vlerën prej 120.000 lekësh, sqaroj se nuk e kam deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005, por në vitin 2010 që është bërë pagesa.

*Sqaroj se mbi kërkesën e vitit 1995 të bashkëshortit tim V. Q. dhe z. M. Q. për shesh ndërtimi për kryerje aktiviteti të përbashkët, fillimisht sipas vendimit nr. ***, datë 15.3.1996, u është dhënë një sipërfaqe e përbashkët. Në kushtet që zona nuk ishte futur në sistem, pas azhurnimit të bërë në vitin 2005 nga Zyra e Urbanistikës, është marrë vendimi nr. ***, datë 28.12.2005, i Këshillit Bashkiak, duke u ridhënë ky shesh ndërtimi. Por në kushtet që gjatë kësaj periudhe ishin pezulluar veprimet nga ana e Bashkisë Sarandë, nuk është bërë e mundur lidhja e kontratës së shitjes së truallit, por vetëm në vitin 2010 na u dha mundësia e pagimit të vlerës së tij. Ne kishim blerë dhe më parë pasuri truall nga Bashkia, për ndërtim banese dhe për aktivitet privat, por nuk kemi pasur mundësi të ndërtonim dhe për shkak të nevojave familjare i kemi shitur ato, ndërsa ky shesh i përket kërkesës dhe vendimit të vitit 1996, tashmë të azhurnuar.*

Pagimi i vlerës prej 240,000 lekësh gjithsej nëpërmjet BKT-së, për llogari të Bashkisë, është kryer nga bashkëshorti im, por se është financuar paraprakisht nga 120,000 lekë secili bashkëpërfitues. Pjesa jonë prej 120,000 lekësh është me burim nga të ardhurat tona familjare.

Z. M. Q. ka parapaguar pjesën e tij prej 120,000 lekësh, 1/2 e pagesës prej 240,000 lekësh. Këtë fakt e provojmë me deklaratë noteriale të vetë personit z. M. Q.. Në kryerjen e veprimit bankar figuron vetëm bashkëshorti im, pasi nuk e pranoin me dy emra.

Sa më lart sqaroj se trualli është fituar fillimisht me vendim në vitin 1996, por në vijim u pezulluan veprimet dhe pagesa është bërë vetëm në vitin 2010 që na u dha mundësia nga ana e bashkisë.

¹⁷ Shihni përgjigjet e ZVRPP-së Sarandë në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

Nga koha e blerjes së saj e deri më tani ky truall nuk është përdorur dhe nuk ka asnjë mundësi përdorimi, pasi ndodhet në zonë ku nuk është hapur ende rruga, e quajtura rruga e 6-shtë.

Bashkëngjitur ju paraqes aktet përkatëse”.

- 5.10** Sipas dokumentacionit që subjekti ka sjellë për të vërtetuar mundësinë e z. M. Q. për pagesën e pjesës së tij takuese në shumën 120,000 lekë, nuk provohet dot burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj shume.
- 5.11** Në analizën financiare është llogaritur nga Komisioni e gjithë vlera e blerjes së truallit prej 240,000 lekësh, në ngarkim të bashkëshortit të subjektit, pasi rezultoi se shuma totale është paguar nga bashkëshorti i subjektit.
- 5.12** Subjekti nuk ka sqaruar se si është përfituar ky truall me sip. 400 m², në vitin 1996. Nuk është deklaruar në DPV-në periodike të vitit 2003 as përfitimi i këtij trualli nga bashkëshorti për shesh ndërtimi për kryerje aktiviteti të përbashkët.
- 5.13** Subjekti nuk ka deklaruar përfitimin e kësaj pasurie sipas vendimit nr. **, datë 15.3.1996, të Bashkisë Sarandë, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratat periodike vjetore.
- 5.14** Vetëm në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010 është deklaruar kjo pasuri nga subjekti.
- 5.15** Nga momenti i blerjes së pasurisë truall dhe marrjes së lejes për shesh ndërtimi nuk rezultoi të jetë kryer ndonjë investim nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për të realizuar ndërtimin dhe qëllimin e marrjes dhe përfitimit të kësaj pasurie tokë truall.
- 5.16** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:
- Pasuria e paluajtshme truall, me sip. 400 m², sipas vendimit të Bashkisë Sarandë, i është dhënë shtetasit V. Q. (bashkëshorti i subjektit), në vitin 2005. Vlerësimi i truallit të kësaj pasurie është bërë në vitin 2006, në vlerën 240,000 lekë dhe pagesa e kësaj vlere është bërë në datën 11.11.2010, në BKT (kalim shume në favor të bashkisë).
 - Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave private periodike/vjetore të viteve 2003 – 2009, pasurinë dhe të drejtat reale të përfituara mbi truallin me sip. 400 m², sipas vendimeve nr. 4, datë 15.3.1996 dhe nr. 89, datë 28.12.2005, të Këshillit Bashkiak Sarandë. Subjekti ka deklaruar vetëm në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2010, si pagesë trualli të kryer për blerje shesh ndërtimi Bashkia Sarandë, në vlerën 120,000 lekë.
 - Qëllimi i fitimit të pasurisë truall ka qenë kryerja e investimit nga subjekti për ndërtim dhe kryerje aktiviteti të përbashkët.
 - Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim për të përfunduar qëllimin e përfitimit të pasurisë truall nga bashkia dhe kryerjen e investimit për ndërtim banese dhe aktivitet privat.
 - Pagesa për blerjen e truallit është bërë nga bashkëshorti i subjektit në vlerën 240,000 lekë dhe subjekti nuk arriti të provonte mundësitë financiare të z. M. Q. për pagesën e pjesës së tij takuese në vlerën 120,000 lekë.
 - Subjekti nuk vërteton mundësinë e ligjshme për blerjen e truallit me sip. 400 m², në vlerën 240,000 lekë, datë 11.11.2010, ndryshimin e likuiditetit, si dhe kryerjen e gjithë shpenzimeve të tjera deri në atë periudhë në masën 892,433 lekë (subjekti nuk

vërteton burimin e ligjshëm edhe nëse do t'i llogaritet vlera e blerjes së kësaj pasurie në shumën 120,000 lekë).

5.17 Për të gjitha gjetjet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

5.18 Në përgjigje të rezultateve¹⁸ subjekti deklaroi:

“Kjo pasuri është krijuar në bashkëpronësi dhe secili bashkëpronar është i detyruar të paguajë shpenzimet e veta për sendin e përbashkët.

Në analizën financiare të llogariten vetëm pjesa e paguar nga bashkëshorti si kontribut i veti në sendin e përbashkët.

Nuk e kam deklaruar përfitimin e kësaj pasurie në deklaratën e vitit 2003, pasi nuk kishim përfituar të drejta reale të pronës.

Bazuar në të ardhurat e deklaruara dhe shpenzimet normale provohet mundësia financiare për blerjen e kësaj pasurie”.

5.19 Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit duke përfshirë të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit me një normë fitimi prej 50% të xhiros vjetore. (shihni në vijim metodologjia). Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare për këtë pasuri si vijon:

5.20 Analiza e mundësisë së blerjes së truallit në datën 11.11.2010

Të ardhura 1.1.2010 – 11.11.2010, subjekti Maria Qirjazi	1,240,568
Të ardhura 1.1.2010 – 11.11.2010, bashkëshorti V. Q.	393,750
Të ardhura bursa M***	848,518
Të ardhura totale	2,482,836
Shpenzime jetese deri më 11.11.2010	283,676
Shpenzime qiraje deri më 11.11.2010	88,000
Shpenzime mobilimi deri më 11.11.2010	366,667
Shpenzime Master Universiteti Justiniani I, Tiranë,	138,810
Shpenzime arsimit + qira fëmijët Greqi deri më 11.11.2010	1,249,845
Shpenzime udhëtimi deri më 11.11.2010	453,648
Shpenzime totale	2,580,646
Ndryshimi i likuiditetit 1.1.2010 – 11.11.2010	475,872
Blerje truall me sip. 400 m ² Sarandë – 11.11.2010	240,000
Pamundësi kursimi në lekë	-813,683

5.21 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

¹⁸ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

5.22 Në bazë të analizës financiare më sipër, edhe sikur të vërtetohej mundësia financiare e z.M. Q. për pagesën e pjesës së tij në vlerën 120,000 lekë, sërish nuk ekziston mundësia e pagesës nga subjekti dhe bashkëshorti të vlerës së blerjes së këtij trualli, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të kësaj periudhe.

6. Apartament 2+1 + garazh në Sarandë

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.1 Subjekti ka deklaruar se ka blerë një apartament 2+1 në Sarandë, me kontratën e datës 13.4.2012. Burimi për krijimin e kësaj pasurie është deklaruar nga të ardhurat e shitjes së apartamentit tjetër 1+1 në Sarandë, në vlerën 30,000 euro, sipas kontratës së shitjes të datës 20.12.2010, si dhe nga të ardhurat familjare. Vlera për blerjen e kësaj pasurie është deklaruar në shumën 6,277,504 lekë.

6.2 Me kontratën e shitblerjes nr. ***/***/**, datë 13.4.2012, me palë shitëse shoqëria “Tulo” sh.p.k., rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë blerë pasurinë apartament banimi me sip. 80 m², në Sarandë, Zona *****, *****, blloku **, parcela **, z. k. *****, me nr. pasurie ***/**, me vlerë 78,468.8 lekë/m², në vlerën e përgjithshme 6,277,504 lekë.

6.3 Kjo shumë sipas kontratës është likuiduar plotësisht nga blerësit jashtë zyrës së noterit. Për këtë veprim rezultoi dhe një mandat urdhërpagese e datës 12.8.2009, kryer nëpërmjet “A** Bank” për kalimin e shumës prej 10.186 euro, nga subjekti te shoqëria “*****” sh.p.k.

6.4 Rezultoi se me urdhërzhirimin e brendshëm datë 23.9.2010, bashkëshorti i subjektit i ka kaluar palës përfituese Th. S. shumën prej 7,500 euro.

6.5 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë regjistruar pasurinë e llojit apartament në z. k. *****, vol. **, f. **, përfituar në bazë të kontratës së shitblerjes datë 13.4.2012.

6.6 Me kontratën e shitblerjes nr. ***/***/**, datë 20.12.2010, subjekti dhe bashkëshorti i ka shitur palës blerëse K. A., apartamentin me sip. 51m², l. nr. **, rruga nr. **, p. **, shk. **, k. **, ap. ** me numër pasurie *****, kundrejt shumës 30,000 euro, në Sarandë.

6.7 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar veprimet për pasuritë e paluajtshme në Sarandë:

- Aplikim kërkesë për regjistrim dhe lëshim certifikate nga shtetasja Maria Qirjazi, datë 11.5.2012; listë dokumentesh; faturë veprimi banke në favor të ZVRPP-së Sarandë datë 23.4.2012, taksë kalimi pronësie; kontratë nr. ***/***/**, datë 13.4.2012 me palë shitëse shoqëria “*****” sh.p.k. dhe palë blerëse subjekti dhe bashkëshorti.
- Vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. *****, në pronësi të shoqërisë “*****” sh.p.k. figuron e regjistruar pasuria nr. ***/**, në z. k. *****, me sip. 80 m², në Sarandë, data e lëshimit të certifikatës 11.4.2012.
- Dokument provues që subjekti dhe bashkëshorti kanë të regjistruar pasurinë e llojit “apartament”, përfituar në bazë të dokumentacionit me nr. ***** dhe se për këtë pasuri është kryer transaksion te persona të tretë. Kryerja e transaksioneve kundrejt palëve të treta është bërë kundrejt vlerës 30,000 euro, shumë të cilën shitësit e kanë marrë tërësisht nga blerësit në dy këste brenda vitit 2010.
- Subjekti dhe bashkëshorti kanë të regjistruar pasurinë nr. *****, të llojit “apartament” me sip. 51m². Vërtetim se shtetasi M. K. nuk ka shesh ndërtimi. Kërkesë datë 28.3.1993

e shtetasit M. V. K. drejtuar Ndërmarrjes Komunale Banesa Sarandë për privatizimin e banesës.

- Kontratë shitjeje nr. ***/**, datë 13.1.1997, të apartamentit nr. **, me vendndodhje në lagjen nr. **, shk. **, k. **, në banesën nr. **/**, rruga nr. **, në Sarandë me palë shitëse M. K. dhe palë blerëse bashkëshortin e subjektit, kundrejt vlerës 3,000,000 dhrahmi greke, likuiduar *cash* jashtë zyrës së noterit.

6.8 DPPPP-ja ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit ka raportime të kontratës noteriale të datës 23.4.2012 për blerje apartamenti me çmim të deklaruar 6,277,504 lekë, nga pala shitëse shtetasi Th. T., përfaqësues ligjor i shoqërisë “*****” sh.p.k.

Për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit ka raportime të kontratës noteriale:

- a) Në datën 20.12.2010 ka shitur një apartament me çmim të deklaruar 30,000 euro me palë blerëse shtetasin K. A. i datëlindjes 9.7.1941.
- b) Në datën 13.4.2012 ka blerë një apartament me çmim të deklaruar 6,277,504 lekë nga pala shitëse shtetasi Th. T., përfaqësues ligjor i shoqërisë “*****” sh.p.k.

6.9 Nisur nga fakti se nuk provoheshin deklaramet e subjektit dhe veprimet e kryera për blerjen e kësaj pasurie, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shprehej lidhur me:

- kur është kryer pagesa e plotë për blerjen e kësaj pasurie nga ana e tyre, si dhe të paraqisnin kopje të dokumentacionit provues për këto pagesa;
- si është përdorur ky apartament nga koha e blerjes deri më sot;
- apartamenti është mobiluar dhe sa është investuar për mobilimin e tij çdo vit duke siguruar dokumentacionin mbështetës;
- burimet për financimin e këtij apartamenti dhe modalitetet e pagesës së tij, duke siguruar dokumente mbështetëse;
- në lidhje me shitjen e kësaj pasurie në vitin 2010 te shtetasi K. A. dhe të sqarojnë kur është bërë pagesa dhe si, duke siguruar dokumentacion provues për secilën prej kësteve;
- si është përdorur ky apartament nga koha e blerjes deri në shitjen e tij, duke specifikuar vit pas viti;
- kërkesën për vënien në dispozicion të një kopje të të dhënave lidhur me pagimin e detyrimeve ndaj OSHEE-së dhe Ujësjiellës Kanalizime, nga dita e lidhjes së kontratës dhe përdorimit të kësaj pasurie nga ana e tyre deri më sot.

6.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*“Në datën 12.8.2009 kemi lidhur aktmarrëveshje për blerjen e një apartamenti banimi dhe një garazhi, në një pallat në Sarandë që po ndërtonte shoqëria ‘*****’ sh.p.k., në vlerën totale 50,000 euro. Kontratat e shitblerjes së pasurive apartament dhe garazh, janë lidhur më vonë, në datën 13.4.2012, përkatësisht apartamenti në vlerën prej 6,277,504 lekësh, që i korrespondon shumës 45,000 euro, si dhe 1 garazh në shumën 5,000 euro, gjithsej 50,000 euro.*

Pagesa për blerjen e kësaj pasurie është kryer me këste në vitet 2009-2010, pjesërisht transferta bankare dhe pjesërisht cash, konkretisht:

- në datën 12.8.2009 është paguar shuma 10,186 euro nga llogaria jonë pranë ‘ALPHA Bank’ sh. a.;
- në datën 17.12.2009 është paguar shuma 2,500 euro po nga llogaria pranë ‘ALPHA Bank’ sh. a., si dhe nga gjendja cash është paguar shuma 2,314 euro, gjithsej 15,000 euro në vitin 2009.

Në verë të vitit 2010 kemi rënë dakord për shitjen e shtëpisë apartament 1+1 në lagjen nr. ** në qytetin e Sarandës, blerësi K. A., me çmimin 30,000 euro. Në muajin gusht kemi marrë nga blerësi parapagim kështu prej 18.000 euro, të cilën në datën 12.8.2010 e kemi depozituar pranë Bankës Popullore (Societe Generale). Nga këto i kemi transferuar shoqërisë ‘****’ sh.p.k. datë 23.9.2010, shumën 7,500 euro dhe në datën 22.10.2010 shumën 5,000 euro, si dhe tërhequr dhe paguar cash shumën e mbetur në bankë prej 5,500 euro. Me pagimin e kështu tjetër 12,000 euro nga blerësi K. A., para lidhjes së kontratës së shitjes në dhjetor të vitit 2010, këtë shumë ia kemi paguar cash shoqërisë ‘****’ sh.p.k. deri në fund të vitit 2010. Kemi pakësuar nga gjendja cash e mbartur shumën 5,000 euro, për plotësimin e pjesës së çmimit 35,000 euro të paguar gjatë vitit 2010, pra, në total 50,000 euro për një apartament dhe një garazh, sipas aktmarrëveshjes datë 12.8.2009.

Ky apartament, nga koha e blerjes deri më sot, është përdorur nga ana jonë kryesisht për pushime.

Apartamenti është mobiluar nga të ardhurat tona sipas viteve përkatëse.

Janë përdorur dhe një pjesë nga pajisjet e apartamentit të shitur, si dhe të shtëpisë me qira në qytetin e Gjirokastrës, pas vitit 2013. Nuk disponojmë dokumentacion mbështetës.

Mbi burimet për financimin e këtij apartamenti dhe pagesën e tij sqaroj se kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit 1+1 dhe të ardhurat tona familjare. Ju paraqes dokumentet bankare për veprimet e kryera me bankë.

Në lidhje me shitjen e apartamentit 1+1 në vitin 2010 të z. K. A. sqaroj se sikurse përcaktohet edhe në kontratë, pagesa është bërë nga ana e tij cash, me këste nga vera e vitit 2010 e deri në lidhjen e kontratës së shitjes me datë 20.12.2010, por nuk kemi mbajtur dhe nuk disponojmë tashmë dokumentacion për pagimin e kësteve.

Ky apartament, nga koha e blerjes së tij në vitin 1997 e deri në vitin 2000, që jam transferuar në Gjirokastrën e Apelit Gjirokastrë, është përdorur për jetesë nga familja jonë, ndërsa pas vitit 2000 e deri në shitjen e tij në vitin 2010 është përdorur nga ne kryesisht për pushime ose gjatë festave.

Detyrimet ndaj OSHEE-së sh.a. dhe Ujësjellës Kanalizime, nga dita e lidhjes së kontratës dhe përdorimit të kësaj pasurie nga ana jonë deri më sot, janë paguar nga ne rregullisht.

Sqaroj se fillimisht kontrata me OSHEE-në ka qenë në emër të shoqërisë ndërtuese ‘*****’ sh.p.k., ndërsa kontratat me banorët u lidhën me vonesë. Nga sa kemi dijeni, kjo për shkakun se në atë zonë nuk kishin instaluar transformator të madh që të përballonte ngarkesën. Kontratën formale me OSHEE-në e kemi lidhur në maj të vitit 2014, duke na u faturuar edhe periudha e mëparshme e përmbledhur me faturën e muajit maj 2014, në vlerën 33,142,24 lekë.

Bashkëlidhur ju paraqes dokumentet përkatëse”.

a. Lidhur me pasurinë garazh në Sarandë

Hetimi i kryer nga Komisioni

6.11 Subjekti ka deklaruar blerjen e një njësie garazh pranë apartamentit të përmendur më sipër, me kontratën e datës 13.4.2012. Burimi është deklaruar nga të ardhura nga pagat dhe kursime familjare. Vlera e deklaruar për blerjen e kësaj pasurie është 697,500 lekë.

6.12 Për këtë pasuri të paluajtshme rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. ***/*****/**, datë 13.4.2012, me palë shitëse shoqëria “*****” sh.p.k., subjekti dhe bashkëshorti kanë blerë

garazh me sip. 14.51 m², në Sarandë, Zona ****, *****, blloku ****, parcela **, z. k. ****, me nr. pasurie ***/****. Vlera, sipas kontratës së shitblerjes, rezultoi 48,070 lekë/m² dhe me vlerën e përgjithshme 697,500 lekë. Kjo shumë, sipas kontratës, është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

6.13 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë të regjistruar pasurinë e llojit “garazh”, përfituar në bazë të kontratës së shitblerjes së datës 13.4.2012.

6.14 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar veprimet për pasuritë e paluajtshme në Sarandë:

- aplikim kërkesë për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës nga subjekti i rivlerësimit, datë 10.5.2012;
- kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. ***/***/****, datë 13.4.2012, me palë shitëse shoqëria “*****” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit V. dhe Maria Qirjazi, të garazhit me nr. **, me sip. 14.51m², në Sarandë, Zona ****, *****, blloku ***, parcela **, z. k. ****, me nr. pasurie ***/****, me vlerë 48,070,3 lekë/m², me vlerën e përgjithshme 697,500 lekë;
- vërtetim nga dokumentet hipotekore në pronësi të shoqërisë “*****” sh.p.k. figuron e regjistruar pasuria nr. **/**, në z. k. ****, me sip. 14.51 m², në Sarandë, me datë lëshimi të certifikatës 11.4.2012.

6.15 Sipas deklarimeve të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pagesat i janë bërë ndërtuesit “*****” sh.p.k. si vijon:

Burimi	Data	Vlera në euro
ALPHA Bank	12.8.2009	10,186
ALPHA Bank	17.12.2009	2,500
Paguar <i>cash</i> nga gjendja <i>cash</i>	17.12.2009	2,314
Total paguar 2009		15,000
Societe General	23.9.2010	7,500
Societe General	22.10.2010	5,000
Tërhequr/Paguar <i>cash</i>		5,500
Paguar <i>cash</i>	dhjetor 2010	12,000
Paguar <i>cash</i> nga kursimet	dhjetor 2010	5,000
Total paguar 2010		35,000
PAGESA TOTALE		50,000

6.16 Transferta e bërë nga “A** Bank”, në vlerën 10,186 euro, përbëhet nga mbyllja e një depozite të mëparshme në vlerën 5,220 euro dhe nga një derdhje e bërë datë 12.8.2009 në vlerën 5,000 euro.

6.17 Subjekti është pyetur për burimin e derdhjes së shumës 5,000 euro, datë 12.8.2009 dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 4 ka deklaruar: “Derdhja prej 5,000 euro në datën 12.8.2009 ishte nga pakësimi i gjendjes *cash* të mbartur nga viti 2008, të cilat i janë transferuar shoqërisë “****” sh.p.k., për llogari të aktmarrëveshjes së lidhur mes nesh në datën 12.8.2009, për blerje apartamenti+garazh.”

- 6.18** Në deklaratën vjetore periodike për vitin 2009 subjekti nuk ka deklaruar ndryshim/zvogëlim të kursimeve *cash*. Kështu që burimi i kësaj derdhjeje nuk është llogaritur nga Komisioni në analizën financiare ndryshimi/zvogëlimi i kursimeve *cash* të deklaruara si gjendje në vitin 2008. Nga ana tjetër, depozita e mbyllur në vlerën 5,220 euro është krijuar nga një derdhje e bërë më 21.11.2007.
- 6.19** Subjekti është pyetur për burimin e derdhjes së vlerës 5,000 euro, datë 21.11.2007, dhe në pyetësonin nr. 4 përgjigjet: “... *ndërsa nga të adhurat familjare është depozituar shuma 5,000 euro, datë 21.11.2007.*”
- 6.20** Bazuar në këtë analizë financiare subjekti nuk e vërteton burimin e ligjshëm të transfertës së shumës 10,186 euro të bërë ndaj shoqërisë “*****” sh.p.k., datë 12.8.2009 sepse nuk provohet burimi i ligjshëm i depozitimit të shumës 5,000 euro, në datën 21.11.2007.
- 6.21** Rezultoi se transfertat tjetër e kryer më 17.12.2009 e ka burimin nga një derdhje e bërë në datën 22.10.2009 nga z. V. Q.. Subjekti është pyetur për burimin e derdhjes së vlerës 2,500 euro, në datën 22.10.2009 dhe në përgjigje të pyetësonit nr. 4 ka deklaruar: “*Ndërsa shuma 2,500 euro, e derdhur në datën 22.10.2009, ka pasur burim kursimet familjare, të cilat i janë transferuar shoqërisë ‘*****’ sh.p.k., në datën 17.12.2009, për llogari të aktmarrëveshjes si më lart*”. Pjesa tjetër e paguar në datën 17.12.2009, në vlerën 2,314 euro deklarohet si e paguar nga kursimet *cash*, por në DPV-në e vitit 2009 nuk deklarohet diçka e tillë.
- 6.22** Analiza financiare është hartuar bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe në ndryshimet e likuiditeteve sipas këtyre deklaratave periodike.
- 6.23** Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për pagesat e bëra në datën 17.12.2009 në vlerat 2,500 euro dhe 2,314 euro, blerjen e pasurive të tjera, si dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1.1.2009 – 17.12.2009.
- 6.24** Pagesat e deklaruara si të kryera gjatë vitit 2010, u pretenduan nga subjekti të kenë si burim vlerën prej 30,000 euro të përfituar nga shitja e apartamentit 1+1. Pjesa e parë e shumës prej 18,000 euro depozitohet te “Societe General A” dhe, më pas, i transferohet shoqërisë “*****” sh.p.k. Pjesa tjetër e shumës prej 12,000 euro u pretendua se është përfituar *cash* nga blerësi i apartamentit dhe i është dhënë *cash* shoqërisë “*****” sh.p.k. Pjesa e fundit e shumës prej 5,000 euro u deklarua se e ka burimin nga kursimet *cash* të deklaruara më parë. Kjo ishte deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2010.
- 6.25** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:
- Subjekti nuk vërteton burimin e ligjshëm të blerjes së pasurisë apartament.
 - Në deklaratën e interesave private të pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar apartament banimi 1+1, lagjja 3, p. 73, Sarandë, me vlerë 1,400,000 lekë (nga shitja e apartamentit 1+1, të përfituar nga ligji për privatizimin e banesave).
 - Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2009, subjekti ka deklaruar pagesë për pronatimi apartamenti banimi në Sarandë, subjektit “*****” sh.p.k. në vlerën 15,000 euro, pa deklaruar burimin.
 - Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2010, subjekti ka deklaruar shitje të apartamentit të banimit në lagjen nr. 3 Sarandë, datë 20.12.2010, në vlerën 30,000 euro dhe pagesë për blerje apartamenti banimi shoqërisë “*****” sh.p.k. Sarandë, në vlerën 35,000 euro, me shënimin (nuk është lidhur kontrata ende, vlera 5,000 euro nga kursimet e mëparshme).

- e) Në deklaratën interesave private periodike/vjetore të vitit 2012, subjekti nuk ka deklaruar blerjen e apartamentit sipas kontratës datë 13.4.2012, por është deklaruar vetëm si pronitim apartamenti në vitin 2009.
- f) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar objektin garazh në Sarandë, me sip. 14.5 m², nr. *****, në vlerën 697,500 lekë, në deklaratat e interesave private periodike/vjetore për vitet 2012 – 2016.

6.26 Për të gjitha gjetjet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6.27 Në përgjigje të rezultateve¹⁹ subjekti deklaroi:

“Pagesa për pasuritë janë shlyer në vitet 2009-2010 dhe shpjegime për këto kam dhënë edhe pranë ILDKPKI-së;

- burimet janë nga të ardhurat e ligjshme;

- pasuria apartament dhe garazh janë blerë në vlerën 50,000 euro;

- në DPV-të përkatëse ka qenë pakujdesi dhe harresë nga ana ime mosdeklarimi i veprimeve juridike për pasurinë garazh;

- edhe mosdeklarimi i gjendjes cash (shitesa dhe pakësime) ka qenë pasaktësi në DPV-të përkatëse;

- bazuar në të ardhurat kam pasur mundësi financiare për blerjen e këtyre pasurive”.

6.28 Komisioni mori në konsideratë disa nga shpjegimet e subjektit duke përfshirë të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit me një normë fitimi prej 50% të xhiros vjetore (shihni më poshtë te metodologjia). Në përfundim, Komisioni hartoi analizën financiare si vijon:

Analiza e mundësisë së depozitimit në vlerën 5,000 euro, më 21.11.2007

Të ardhura 1.1.2007 – 21.11.2007, subjekti Maria Qirjazi	1,004,932
Të ardhura 1.1.2007 – 21.11.2007, bashkëshorti V. Q.	687,500
Të ardhura totale	1,692,432
Shpenzime jetese deri më 21.11.2007	474,849
Shpenzime qiraje deri më 21.11.2007	88,000
Shpenzime udhëtimi deri më 21.11.2007	106,134
Shpenzime totale	668,984
Ndryshimi i likuiditetit 1.1.7 – 21.11.2007	2,453,714
Blerë lokal shërbimi me sip. 32 m ² Sarandë	1,980,000
Pamundësi kursimi në lekë	-3,410,266
Pamundësi kursimi në euro	- 28,205

Analiza e mundësisë së kursimit në vlerën 4,814 euro, më 17.12.2009

Të ardhura 1.1.2009 – 17.12.2009, subjekti Maria Qirjazi	1,398,292
Të ardhura 1.1.2009 – 17.12.2009, bashkëshorti V. Q.	575,000
Të ardhura nga bursa Melina Qirjazi deri më 17.12.2009	987,624

¹⁹ Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

Të ardhura totale	2,960,916
Shpenzime jetese deri më 17.12.2009	305,498
Shpenzime qiraje deri më 17.12.2009	108,000
Shpenzime arsimit + qira fëmijët Greqi deri më 17.12.2009	1,415,594
Shpenzime arredimi apartament ***** deri më 17.12.2009	250,000
Shpenzime udhëtimi deri më 17.12.2009	228,213
Shpenzime totale	2,307,305
Blerje automjet tip Benz 900,000 lekë – 27.3.2009	900,000
Paguar 10,186 euro apartament Sarandë - 12.8.2009	1,397,214
Paguar 4,814 euro (2,500 + 2.314) – 17.12.2009	660,336
Ndryshimi i likuiditetit 1.1.09 – 17.12.2009	-1,830,280
Ndryshim pasurie deri 17.12.2009	1,127,270
Pamundësi kursimi në lekë	-473,659
Pamundësi kursimi euro	- 3,453

6.30 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, nuk ka deklaruar pasurinë garazh dhe kontratën përkatëse në DPV, si dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament.

7. Garazh në Sarandë, blerë në vitin 2012

7.1 ILDKPKI-ja ka deklaruar: *“Fshehje e garazhit me sip. 14.5 m², nr. *****, në vlerën 697,500 lekë, në Sarandë në deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2012 -2016”*.

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.2 Subjekti ka deklaruar blerjen e një njësie garazh pranë apartamentit të përmendur më sipër në pikën 6 të këtij vendimi, me kontratën e datës 13.4.2012. Burimi është deklaruar nga të ardhurat familjare. Vlera e deklaruar për blerjen e kësaj pasurie është 697,500 lekë.

7.3 Për këtë pasuri të paluajtshme rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 13.4.2012, me palë shitëse shoqëria “*****” sh.p.k., kanë blerë garazh me sip. 14.51 m², në Sarandë, Zona *****, *****, blloku ***, parcela **, z. k. ****, me nr. pasurie *****. Vlera sipas kontratës së shitblerjes rezultoi 48.070 lekë/m² dhe me vlerën e përgjithshme 697,500 lekë. Kjo shumë sipas kontratës është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

7.4 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë të regjistruar pasurinë e llojit “garazh”, përfituar në bazë të kontratës së shitblerjes të datës 13.4.2012.

7.5 ZVRPP-ja Sarandë ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar veprimet për pasuritë e paluajtshme në Sarandë:

- aplikim kërkesë për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës nga subjekti i rivlerësimit, datë 10.5.2012;
- kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *****, datë 13.4.2012 me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k. dhe palë blerëse V. dhe Maria Qirjazi, të garazhit me nr. ***, me sip. 14.51m², në Sarandë, Zona Turizëm, *****, Blloku ***, parcela **, z. k. ***,

me nr. pasurie *****, me vlerë 48,070,3 lekë/m², me vlerën e përgjithshme 697,500 lekë;

- vërtetim nga dokumentet hipotekore, në pronësi të shoqërisë “*****” sh.p.k. figuron e regjistruar pasuria nr. *****, z. k. ***, me sip. 14.51 m² në Sarandë, data e lëshimit të certifikatës 11.4.2012.

7.6 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore për vitet 2012 – 2016.

7.7 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar:

*“Në lidhje me blerjen e garazhit të dytë sqaroj se në bazë të marrëveshjes sonë me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. në datën 12 gusht 2009, kishim rënë dakord për blerjen e një apartamenti 100 m² (sipërfaqe e brendshme 88 m²), në shumën 50,000 euro, ku përfshihej edhe një garazh pranë tij. Kjo shumë (çmimi apartament + 1 garazh) prej 50,000 euro është likuiduar nga ana jonë në vitet 2009-2010, sikurse sqaroj edhe në përgjigje të pyetjes 7, ndërsa nuk kishim lidhur ende kontratën noteriale të shitjes së tyre.*

Sa më lart, i kam deklaruar në deklaratat e viteve 2009-2010, si edhe në ILDKPKI kur jam thirrur në vitin 2011, sipas procesverbalit që ju paraqes bashkëlidhur, si dhe akteve shkresore të dorëzuara pranë saj.

Në vitin 2012 kur lidhëm kontratat e shitblerjes për apartamentin dhe 1 garazh, të likuiduara tashmë në vitet 2009 - 2010, ramë dakord të blejmë edhe 1 garazh tjetër në krah me të parin, në çmimin prej 697,500 lekësh. Kjo vlerë është paguar cash në kohën e lidhjes së kontratës datë 13.4.2012, me burim gjendjen cash të të ardhurave familjare të mbartura prej vitit 2011. Blerjen e garazhit të dytë e kam deklaruar në vitin 2012 kur lidhëm kontratën dhe kryem pagesën.

Bashkëlidhur ju paraqes: procesverbal i shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI dhe aktdorëzimi i provave shkresore”.

7.8 Sipas deklarimit periodik vjetor të vitit 2012 rezultoi se subjekti e ka deklaruar pasurinë garazh dhe burimi i kësaj pasurie është deklaruar “me të hollat nga kursimet familjare”. Në përgjigjet e pyetësorit, ku subjekti sqaron deklarimin e kursimeve cash, në vitin 2012, pretendon zvogëlim të gjendjes cash në vlerën 697,500 lekë për blerjen e këtij garazhi.

7.9 Në përfundim të hetimit Komisioni arriti në konkluzionin se:

- a) Në deklaratën periodike të vitit 2012 subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin (zvogëlimin e gjendjes cash), në shumën 697,500 lekë.
- b) Subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë garazh në vitin 2012²⁰.

7.10 Për të gjitha gjetjet e më sipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7.11 Subjekti paraqiti prapësime në përgjigje të rezultateve të hetimit²¹. Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit referuar edhe deklarimit në DPV-në e vitit 2012, ku vlera prej 697,500 lekësh i është zbritur gjendjes cash të vitit të mëparshëm.

7.12 Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe burimin e krijimit.

²⁰ Shihni analizën financiare për vitin 2012.

²¹ Shihni prapësimet e subjektit të bëra në përgjigje të rezultateve të hetimit.

8. Depozitë në vlerën 5,006 euro, në “R Bank”**

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 8.1** Subjekti ka deklaruar krijimin e një depozite në “R** Bank” sh.a. dhe si burim krijimi janë deklaruar të ardhurat nga shitjet e magazinës me kontratën e datës 31.10.2013 dhe shitjes së automjetit tip “Ford” me kontratën e datës 25.11.2013. Vlera e deklaruar e depozitës është 5,006 euro.
- 8.2** Bazuar në konfirmimin e “R** Bank” rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje në euro në datën 19.1.2017, vlerën 5,006.46 euro.
- 8.3** Me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 31.10.2013, bashkëshorti i subjektit i ka shitur palës blerëse T. Q. pasurinë objekt njëkatëshe me sip. 77m² dhe truall në ***, D**, kundrejt vlerës 2,756,600 lekë. Kjo shumë rezultoi se është likuiduar jashtë zyrës së noterit.
- 8.4** Bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë pasuri me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 1.11.2000, me palë shitëse E. M. kundrejt vlerës 85,000 lekë, shumë e cila sipas kontratës është likuiduar tërësisht jashtë zyrës së noterit.
- 8.5** Me kontratën nr. *****, datë 25.11.2013, është shitur automjeti tip “Ford” në vlerën 250,000 lekë. Automjeti u ble nga z. V. Q. me kontratën nr. *****, datë 27.4.2004, në vlerën 200,000 lekë dhe shpenzimet doganore me vlerë 152,359 lekë.
- 8.6** DPPP-ja ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit, me kontratën noteriale të datës 31.10.2013, ka shitur pasurinë e paluajtshme me çmim të deklaruar 2,756,600 lekë me palë blerëse shtetasin T. Q..
- 8.7** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:
Rezultoi një diferencë e madhe nga vlera e blerjes së pasurisë magazinë nga bashkëshorti i subjektit në shumën prej 85,000 lekësh në vitin 2000, në vlerën e shitjes në vitin 2013 në shumën prej 2,756,600 lekësh, burim i cili ka shërbyer për krijimin e depozitës me vlerë 5,006 euro.
- 8.8** Për gjetjen e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- 8.9** Në përgjigje të rezultateve, subjekti deklaroi:
“Diferenca midis vlerës së blerjes së pasurisë magazinë në shumën prej 85,000 lekësh dhe shitjes në shumën prej 2,756,600 lekësh ka të bëjë me faktin se blerja ka qenë nga personi i cili e ka privatizuar nga shteti me çmim të lirë dhe e shiti sepse nuk kishte interes për atë objekt, pasi nuk ishte banor i fshatit.
- Pas shumë vitesh si çdo pasuri edhe kjo kishte marrë vlerë në treg duke qenë brenda fshatit dhe e përshtatshme për aktivitet privat”.
- 8.10** Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti nuk arriti të provojë se si një pasuri e blerë në vlerën 85,000 është shitur më pas në vlerën 2,756,600 lekë, shumë e cila ka shërbyer për krijimin e depozitës bankare me vlerë 5,006 euro.

9. Depozitë në vlerën 5,002 euro, në “I S** Bank”**

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 9.1** Subjekti ka deklaruar depozitë në “I** S** Bank”. Burimi është deklaruar nga shitja e magazinës me kontratën e datës 31.10.2013 dhe shitja e automjetit tip “Ford” me kontratën e datës 25.11.2013. Vlera e deklaruar e depozitës është 5,002 euro.
- 9.2** “I** S** Bank” ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit ka gjendje në llogarinë pranë kësaj banke shumën 5,002.48 euro.
- 9.3** Me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 31.10.2013, bashkëshorti i subjektit i ka shitur palës blerëse T. Q., pasurinë objekt njëkatësh me sip. 77m² dhe truall në *** D**, kundrejt vlerës 2,756,600 lekë. Kjo shumë rezultoi se është likuiduar jashtë zyrës së noterit.
- 9.4** Bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë pasuri me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 1.11.2000, me palë shitëse E. M. kundrejt vlerës 85,000 lekë, shumë e cila sipas kontratës është likuiduar tërësisht jashtë zyrës së noterit.
- 9.5** Me kontratën nr. *****, datë 25.11.2013, është shitur automjeti tip “Ford” në vlerën 250,000 lekë. Automjeti u ble nga z. V. Q. me anë të kontratës nr. *****, datë 27.4.2004, në vlerën 200,000 lekë dhe shpenzimet doganore me vlerë 152,359 lekë.
- 9.6** DPPP-ja ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit me kontratën noteriale të datës 31.10.2013 ka shitur pasurinë e paluajtshme me çmim të deklaruar 2,756,600 lekë me palë blerëse shtetasin T. Q..
- 9.7** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se rezultoi një diferencë e madhe nga vlera e blerjes së pasurisë magazinë nga bashkëshorti i subjektit në shumën prej 85,000 lekësh në vitin 2000, në vlerën e shitjes në vitin 2013 në shumën prej 2,756,600 lekë, burim i cili ka shërbyer për krijimin e depozitës me vlerë 5,002 euro.
- 9.8** Për gjetjen e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- 9.9** Subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve dhe nga Komisioni u vlerësua se është i njëjti qëndrim dhe konkluzion si për pasurinë (depozitë bankare) e përmendur në pikën 8 më sipër në këtë vendim.

10. Depozitë në vlerën 5,006 euro, në NBG

Hetimi i kryer nga Komisioni

- 10.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë në NBG me burim nga shitja e magazinës me kontratën e datës 31.10.2013 dhe shitja e automjetit tip “Ford” me kontratën e datës 25.11.2013, si dhe të ardhura familjare të akumuluar. Vlera e deklaruar është në shumën 5,006 euro.
- 10.2** NBG-ja ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka një depozitë bankare me gjendje në shumën 5,006.26 euro.
- 10.3** Me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 31.10.2013, bashkëshorti i subjektit i ka shitur palës blerëse T. Q., pasurinë objekt njëkatëshe me sip. 77m² dhe truall në *** D**, kundrejt vlerës 2,756,600 lekë. Kjo shumë rezultoi se është likuiduar jashtë zyrës së noterit.

- 10.4** Bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë pasuri me kontratën e shitblerjes nr. *****, datë 1.11.2000, me palë shitëse E. M. kundrejt vlerës 85,000 lekë, shumë e cila sipas kontratës është likuiduar tërësisht jashtë zyrës së noterit.
- 10.5** DPPPP-ja ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit me kontratën noteriale, datë 31.10.2013, ka shitur pasurinë e paluajtshme me çmim të deklaruar 2,756,600 lekë me palë blerëse shtetasin T. Q..
- 10.6** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se rezultoi një diferencë e madhe nga vlera e blerjes së pasurisë magazinë nga bashkëshorti i subjektit në shumën 85,000 lekë në vitin 2000, në vlerën e shitjes në vitin 2013, në shumën 2,756,600 lekë, burim i cili ka shërbyer për krijimin e depozitës në vlerën 5,006 euro.
- 10.7** Për gjetjen e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- 10.8** Subjekti paraqiti shpjegime në përgjigje të rezultateve dhe nga Komisioni u vlerësua se është i njëjti qëndrim dhe konkluzion si për pasurinë (depozitë bankare) e përmendur në pikën 8 më sipër në këtë vendim.

11. Apartament me sipërfaqe 21 m² në Sarandë

- 11.1** ZVRPP-ja Sarandë (sipas praktikës së administruar nga ILDKPKI-ja) ka konfirmuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi një pasuri të llojit “apartament” me sip. 21m², me nr. pasurie *****, z. k. ***, vol. **, f. ***.
- 11.2** Ky objekti është ndërtuar në truallin në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me sip. 354m² i regjistruar në ZVRPP Sarandë në regjistrin hipotekor nr. ***, f. ***, indeksi nr. ***, datë 26.11.2002.
- 11.3** Për këtë pasuri rezultoi aktshkëmbimi nr. *****, datë 26.8.2010, me palë bashkëshorti i subjektit si pronar i truallit dhe shtetasit A. Sh., D. Sh., B. H. si investitorë të përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A. Ç. (prokura me datë 26.8.2010, të përfaqësuarit janë bashkëpronarë në një godinë në Sarandë në *****, e cila është e regjistruar në ZVRPP Sarandë në regjistrin hipotekor f. ***, nr. indeksi ***, datë 26.8.2010, pasuria nr. *****, z. k. ***). Në këtë akt, investitorët bien dakord, meqenëse punimet kanë përfunduar dhe objekti është i regjistruar në ZVRPP, kalojnë në këmbim të truallit që marrin nga z. V. Q., në favor të bashkëshortit të subjektit, apartamentin e banimit në katin përdhës me sip. 21m². Sipërfaqen e truallit prej 345 m² bashkëshorti i subjektit ia kalon në pronësi shtetasve A. Sh., D. Sh. dhe B. H. dhe këta të fundit këtë sipërfaqe e vënë në dispozicion të të gjithë godinës objekt shkëmbimi.
- 11.4** Bazuar në vërtetimin hipotekor rezultoi se në emër të bashkëshortit të subjektit figuron e regjistruar pasuria në z. k. ***, me sip. 345 m², në *****, parcela ***Sarandë, me datë lëshimi vërtetimi 26.8.2010. Për këtë pasuri është vendosur barrë mbi pasurinë – i vlefshëm vetëm për kryerje të kontratës së shkëmbimit me shtetasit A. Sh., D. Sh. dhe B. H.. Harta treguese e pasurisë nr. ***, z. k. ***dhe vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. *****. Në emër të shtetasve A. Sh., D. Sh. dhe B. H. figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***me sip ndërtimi 183 m² me vendndodhje *****, *****, parcela *** Sarandë, me datë lëshimi vërtetimi 26.8.2010, barrë mbi pasurinë – i vlefshëm vetëm për kryerje të kontratës së shkëmbimit me pronarin e truallit, z. V. Q..
- 11.5** Kartela e pasurisë së paluajtshme me z. k. ***, nr. pasurie *****, vol. ***, f. ***, e llojit “apartament” me sip. 21 m², rezultoi në emër të z. V.Q., me vendndodhje në rrugën “*****” me kontratë shkëmbimi në vitin 2010, data e regjistrimit 5.8.2014.

11.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pas kërkesës për shpjegime nga Komisioni, subjekti, për këtë pasuri, ka deklaruar:

“Në përgjigje të pyetjes tuaj mbi kërkesën e bërë nga ana ime pranë ASHK Sarandë, jam vënë në dijeni të origjinës së kësaj pasurie dhe sqaroj se:

*Me bashkëshortin tim kemi pasur një pasuri të llojit ‘truall’ në qytetin e Sarandës, me sipërfaqe 345 m², ndodhur në ‘*****’, ‘*****’. Për këtë sipërfaqe, bashkëshorti im, në cilësinë e porositesit, ka nënshkruar më 12.11.2003 një kontratë sipërmarrjeje me investitorët: z. D. Sh., znj. A. Sh. dhe z. B. H.. Në bazë të kësaj kontrate kemi vënë në dispozicion truallin e sipërcituar me qëllim ndërtimin e një strukture banimi e shërbimi. Për shkak të nevojave familjare, ne zgjodhëm të mos prisnim sa të ndërtohej sendi i ardhshëm dhe në atë kontratë është rënë dakord që, pjesa takonjëse e sipërfaqes ndërtimore do të na paguhej në vlerë, në shumën 3,000,000 lekë, duke hequr dorë nga pronësia e truallit në këtë mënyrë. Kjo shumë është përfituar qysh atëherë dhe është deklaruar në deklaratën periodike.*

Prej asaj kohe, me marrjen e lekëve ne s’mund të kishim pretendime për tokën, pasi faktikisht u zhveshëm nga pronësia, e për më tepër mbi të u realizua ndërtimi nga ana e investitorëve. Morëm vesh më vonë se investitorët kishin hasur probleme me regjistrimin e ndërtimit në ish- ZVRPP-në Sarandë, probleme që i zgjidhën me vendimmarrje gjyqësore. Për të kryer regjistrimin e tokës, në vitin 2010, mbi kërkesën e investitorëve bëhet një akt këmbimi midis tyre dhe bashkëshortit tim (pasi trualli ende figuronte në ZVRPP në emrin e bashkëshortit), duke e këmbyer me një sipërfaqe ndërtimore 21 m². Thuhet apartament, por një sipërfaqe e tillë dhe vendndodhja e tij, nuk mund të ketë standarde apartamenti.

Duke qenë se ne ishim likuiduar qysh në vitin 2003 për vlerën e truallit apo sendit të ardhshëm, brenda pak ditësh, në datën 15.9.2010, bëhet një kontratë shitjeje për këtë send, me blerëse një të zgjedhur nga investitorët. Në këtë kontratë pranohet fakti se paratë e shitjes nuk do t’i merrte: V. dhe Maria Qiriaz, por A. Sh., D. Sh. dhe B.H.. Po në këtë kontratë pranohet e njihet fakti se ‘investitorët kanë paguar nëpërmjet kontratës për shitblerje trualli’.

*Në interpretim të kontratës sa sipër, duke mos marrë ne asnjë vlerë si çmim shitjeje, është pranuar fakti i heqjes dorë nga pronësia mbi sendin me nr. pasurie ‘*****’, zona kadastrale ‘***’, me sipërfaqe 21 m², ‘*****’, blloku ‘***...’.*

Mbi pyetjen se pse kjo pasuri nuk është deklaruar nga ana ime, sqaroj se nga pikëpamja formale pronësia e fituar në gusht 2010, u shit pas 20 ditëve pa shpërblim, me kontratën e datës 15.9.2010, pra, në këto kushte s’kisha se çfarë të deklaroja në fund të vitit sipas ligjit. Formalisht qysh nga çasti i ‘shitjes’ nuk kemi qenë bashkëpronarë të sendit. Nga ana tjetër, është zgjedhje e blerësit ta regjistrojë pronësinë mbi sendin apo jo. Mbi pyetjet tuaja dhe interesimin tonë, kemi konstatuar se kontrata e shitjes e datës 15.9.2010, nuk është regjistruar nga ana e blerëses në ZVRPP (ASHK).

Porse, referuar vendimit unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, në qëndrimin e saj unifikues përcakton se: ‘Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie’.

Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me të qenit pronar mbi këtë pasuri. Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij”.

Aktualisht, i gjithë ndërtimi i kryer prej investitorëve, nga fillimi e deri më sot, është përdorur dhe përdoret qetësisht nga investitorët, pa pasur ne asnjë pretendim apo përfitim tjetër, pas marrjes së vlerës së deklaruar që në vitin 2003.

Bashkëlidhur ju paraqes kontratat përkatëse, atë të sipërmarrjes datë 12.11.2003, kontratë shkëmbimi dhe kontratë shitje të datës 2010.

Bashkëngjitur ju paraqes aktet përkatëse”.

11.7 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:

- a) Është i dyshimtë fakti i përfitimit në vitin 2010, të apartamentit me sip. 21m², nga investitorët A. dhe D. Sh. etj., me të cilët për shkëmbimin e truallit është bërë likuidimi që në vitin 2003, në vlerë monetare dhe pa pretendime të tjera në të ardhmen.
- b) Kontrata e shkëmbimit nuk duket se është bërë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe ndoshta është bërë më qëllim shmangien e detyrimeve përkatëse fiskale në buxhetin e shtetit. Kjo duket se përforcohet dhe nga subjekti pasi shkëmbimi i truallit duhet të bëhet me sipërfaqe ndërtimi dhe jo në vlerë financiare (kontrata me vlerë financiare sipas Kodit Civil është kontrata e shitjes së pasurisë).
- c) Subjekti nuk ka deklaruar apartamentin me sip. 21 m² në Sarandë, si në deklaratën e rivlerësimit *Vetting* dhe në deklaratat e interesave private ndër vite.
- d) Subjekti nuk ka deklaruar aktshkëmbim pasurie të paluajtshme nr. *****, datë 26.8.2010 dhe as vlerën e përmendur në kontratë si në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e interesave private periodike vjetore të periudhës 2010 – 2016.

11.8 Për të gjitha gjetjet e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe për të paraqitur provat për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

11.9 Në përgjigje të rezultateve²² subjekti deklaroi:

“Pas realizimit të investimit nuk arrihej të regjistrohej prona dhe për këtë qëllim u hartua kontrata e shkëmbimit në vitin 2010 me investitorët;

- *nga kontrata e shkëmbimit nuk është përfituar asnjë vlerë financiare pasi ishim shlyer me investitorët;*
- *këto veprime nuk janë bërë me qëllim shmangien e detyrimeve në buxhetin e shtetit dhe pagimi i tyre bëhet në momentin e regjistrimit të pronës;*
- *nga pakujdesia e blerësit kontrata nuk u dërgua nga pala blerëse në ZVRPP, duke mos bërë të mundur pagimin e tatimit;*
- *kjo pasuri nuk është deklaruar nga ana ime në DPV-në e vitit 2010, pasi nga ana formale është përfituar dhe shitur brenda vitit”.*

11.10 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, nuk ka deklaruar veprimet ligjore të kryera në DPV-të përkatëse, me anë të formës së kontratave dhe veprimeve të kryera, janë shmangur detyrimet financiare në buxhetin e shtetit, si dhe ka kryer veprime fiktive që cenojnë figurën e saj si gjyqtare.

12. Deklarimet e gjendjes *cash* ndër vite

12.1 Në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar “kursime nga të ardhura familjare”.

²² Shihni përgjigjet e subjektit mbi rezultatet e hetimit.

12.2 Nisur nga fakti se Komisioni konstatoi disa pasaktësi lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash*, i kërkoi subjektit:

- të sqarojë nëse shumat *cash* që janë deklaruar prej saj në deklaratat periodike vjetore gjatë gjithë periudhës së deklaratimit, janë shtesa të çdo viti në krahasim me vitin paraardhës apo nëse janë deklaruar si gjendja totale e kursimeve që disponoheshin në momentet e deklarimeve;
- të deklarojë gjendjen e kursimeve *cash* në fund të secilit prej viteve.

12.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me gjendjen *cash*, ndër vite, subjekti ka deklaruar:

*“Në deklaratat periodike vjetore në vitet e para nuk kam deklaruar gjendje *cash* kursime, nga paqartësia në plotësimin e formularit të deklaratës. Formulari i vitit 2003, në faqen 2, ‘s qarime mbi plotësimin e formularit’ nuk parashikonte tek rubrika ‘pasuri e luajtshme’ përcaktimin e gjendjes së parave, por vetëm pasuritë e luajtshme me regjistrim publik (automjete etj.). Ndërsa formularët e viteve 2006 dhe 2007 nuk përcaktonin deklaratimin e likuiditeteve, sikurse në formularët e mëvonshëm.*

Sqaroj se të hollat që janë deklaruar nga ana ime si kursime familjare në deklaratat vjetore gjatë periudhës së deklaratimit, janë shtesa në fund të atij viti nga të ardhurat vjetore dhe jo gjendja totale e kursimeve në momentet e deklarimeve.

*Nga gjendja *cash* e mbartur nga vitet e mëparshme shpesh janë përdorur për shpenzimet e kryera në fillim të vitit dhe gjendjes së mbetur i shtohet në fundvit shuma e kursyer e atij viti.*

*Gjendja e kursimeve *cash* në fund të secilit prej viteve, nga sa kujtojmë me përafërsi, ka qenë:*

- në fund të vitit 2003 gjendja *cash* e akumuluar ka qenë në shumën rreth 900,000 lekë;
- në fund të vitit 2004 kemi pasur gjendje *cash* rreth 800,000 lekë;
- në vitin 2005 është shtuar gjendja *cash* nga kursimet familjare të atij viti në shumën 400.000 lekë, pra gjithsej gjendja *cash* në fundvit ka qenë 1,200,000 lekë;
- në vitin 2006 është shtuar shuma *cash* prej 1,850,000 lekësh sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë 2.5.2006, dhe shuma 350,000 lekë kursime *cash* nga të ardhurat familjare të vitit, në total gjendja *cash* në fundvit gjithsej 3,400,000 lekë;
- në vitin 2007 pakësuar nga gjendja *cash* e vitit 2006, përdorur shuma 1,980,000 lekë për blerjen e dyqanit, shtuar shuma 400,000 lekë nga kursimet *cash* nga të ardhurat e atij viti, pra, gjithsej rreth 1,800,000 lekë *cash*;
- në vitin 2008 është shtuar shuma 400,000 lekë *cash* nga kursimet familjare vjetore, pra, gjithsej 2,200,000 lekë në fundvit;
- në vitin 2009 është pakësuar gjendja me 700,000 lekë të depozituara në bankë (5,000 euro), pakësuar shuma 350,000 lekë shpenzime, dhe shtuar nga kursimet vjetore shuma 400,000 lekë, në fundvit gjithsej 1,550,000 lekë *cash*;
- në vitin 2010 është pakësuar shuma 700,000 lekë nga gjendja *cash* e mbartur (baraz me 5,000 euro) për plotësim të çmimit të blerjes apartamentit dhe 1 garazh nga shoqëria ‘*****’ sh.p.k., si dhe pakësuar 400,000 lekë për arredim + shpenzime, shtuar nga kursimet *cash* të atij viti 700.000 lekë, gjithsej në fundvit 1,150,000 lekë *cash*;
- në vitin 2011 është shtuar shuma 1,000,000 lekë kursime *cash*, gjithsej në fundvit gjendja 2,150,000 lekë;
- në vitin 2012 nga gjendja *cash* e mbartur është pakësuar shuma 697,500 lekë për blerjen e një garazhi të dytë, pakësuar në vlerën 5,000 euro për depozitë në bankë,

shpenzuar familja 150,000 lekë, duke mbetur gjendja në fundvit në shumën 600,000 lekë;

- *në vitin 2013 nga gjendja cash pakësuar për shpenzime shuma 500,000 lekë, shtuar cash të ardhurat nga shitjet e magazinës, shuma 2,756,600 lekë dhe të automjetit tip 'Ford' shuma 250,000 lekë, shtuar nga kursimet vjetore shuma 400,000 lekë, pra gjithsej në fundvit 3,500,000 lekë;*
- *në vitin 2014 pakësuar gjendja cash 450,000 lekë për fëmijët, pakësuar 150,000 lekë për arredim dhe 200,000 lekë djalit Th*** për pagesë masteri, janë konvertuar në euro nga gjendja cash në lekë, duke pakësuar me -2,100,000 lekë (=15,000 euro), duke mbetur shuma 600,000 lekë, shtuar shuma prej 500,000 lekësh kursime vjetore, pra, gjithsej gjendja cash në fundvit prej 1,100,000 lekësh dhe 15,000 euro;*
- *në vitin 2015 pakësuar shuma cash 15,000 euro, depozituar në banka, pakësim i të gjithë gjendjes cash në lekë të mbartur prej 1,100,000 lekësh për shpenzimet e vajzës M***, studime master, shtuar gjendja cash në fundvit nga kursimet vjetore prej 400,000 lekësh;*
- *për vitin 2016 pakësuar gjendja cash me 150,000 lekë, duke mbetur në fundvit shuma 250,000 lekë cash;*
- *në vitin 2017 shtuar gjendjes cash 4,000 euro dhe 200,000 lekë kursimet vjetore, gjithsej cash në fundvit 4,000 euro dhe 450,000 lekë;*
- *në vitin 2018 pakësuar, duke përdorur nga gjendja cash shumën 400,000 lekë për bileta dhe pushime, shtuar gjendja cash në fundvit nga të ardhurat familjare me 100,000 lekë, gjithsej cash në fundvit 4,000 euro dhe 150,000 lekë”.*

12.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni e kreu llogaritjen e gjendjes cash, ndër vite, si dhe pasqyrimin e saj në analizën financiare²³, duke u bazuar në deklaratat periodike vjetore të paraqitura nga subjekti në ILDKPKI.

13. Shpenzimet e studimeve

13.1 Subjekti ka deklaruar së fëmijët e saj kanë kryer studime në shtetin grek.

13.2 Meqenëse Komisioni nuk kishte të dhëna të plota lidhur me të gjitha shpenzimet e kryera për shkollim, subjektit iu kërkua të sqarojë dhe të dokumentojë se cilat kanë qenë shpenzimet për studimet e kryera në Athinë nga fëmijët e saj, sa kanë qenë pagesat e shkollimit dhe sa shpenzimet e jetesës, si dhe burimin e këtyre pagesave vit pas viti.

13.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 lidhur me shpenzimet e kryera për shkollim, subjekti ka deklaruar:

*“Për studimet e kryera në Athinë nga fëmijët tanë, sqaroj se nuk kanë pasur pagesa shkollimi për universitetet ku kanë studiuar (publike), përveç pagesave të kryera nga djali Th*** për studime master në këste, konkretisht:*

- *në datën 5.11.2013, shuma 1,800 euro;*
- *në datën 5.3.2014, shuma 1,800 euro;*
- *në datën 31.12.2014, shuma 600 euro;*
- *në datën 11.6.2015, shuma 1,200 euro.*

*Të dy fëmijët gjatë gjithë viteve të shkollimit kanë përfituar në bazë të ligjit grek ushqim falas në mensat e universitetit, deri në marrjen e diplomës dhe masterit. Djali Th*** vitin e parë të shkollës (2007 - 2008) ka përfituar kompensim 100 euro/muaj, pasi universiteti nuk siguronte konvikt. Fatkeqësisht nuk disponojmë dokumente pas kaq vitesh. Gjatë vitit*

²³ Shihni analizën financiare në pikën 15 të këtij vendimi.

të parë djali ka ndenjur në familjen e motrës time R. V. në Athinë, Greqi, pa asnjë shpenzim, ndërkohë që ushqehet në mensën e universitetit.

*Vajza M*** ka qenë përfituese e bursës së studimit nga Ministria e Jashtme e Greqisë për 6 vite, në shumën 38,088 (tridhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e tetë) euro, tërhequr me këste ndër vite. Gjithashtu, ka përfituruar në vitin 2012 shumën 600 euro nga praktika e punës në spital në Athinë.*

*Shpenzimet kanë qenë kryesisht për qiranë e banesës në shumën 290 euro/muaj, të cilat në periudhën e përfitim të bursës nga vajza M*** në vitet 2008 - 2014 janë paguar prej saj.*

*Përveç bursës së vajzës, kemi paguar për studime master të djalit në datën 5.3.2014, shuma 1,800 euro (=250,000 lekë) dhe kompensuar për shpenzime jetese të fëmijëve në vitin 2014 në shumën 450,000 lekë. Ndërsa prej vitit 2015 e në vijim janë përballuar nga të ardhurat e punësimit të djalit Th****. Bashkëngjitur ju paraqes aktet përkatëse”.*

13.4 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit deklarojë të gjitha shpenzimet e jetesës së djalit të saj që ka punuar në Athinë në vitet 2015 dhe 2016 dhe të vajzës që ka punuar në Londër në vitin 2016, si dhe sa ka qenë kontributi i subjektit për këto shpenzime, duke shpjeguar burimin e financimit të shpenzimeve dhe duke paraqitur prova.

13.5 Në përgjigje të pyetëtorit nr. 2 lidhur me shpenzimet e kryera për jetesë, subjekti ka deklaruar:

“Shpenzimet e jetesës së djalit në Athinë në vitet 2015 dhe 2016 kanë qenë në shumën rreth 8,000 euro/vit, përballuar nga të ardhurat e punësimit të tij në këto vite. Sipas deklarimeve në organet tatimore të shtetit grek ku ka punuar, djali ka përfituruar të ardhura nga puna e tij për vitin 2015 në shumën 12,997 euro (përfshirë dhe TVSH-në e kthyeshme) dhe për vitin 2016 shumën 20,048 euro.

*Ndërsa shpenzimet e jetesës së vajzës në Londër në vitin 2016 kanë qenë në shumën 11,885 paund, pagesa shkolle dhe akomodimi, me burim financimi konkretisht shuma 10,000 euro nga llogaria jonë bankare në ‘Bankën Popullore’ (S** G**) dhe shuma 1,100,000 lekë nga gjendja cash e të ardhurave familjare. Për vajzën janë përdorur nga të ardhurat vjetore tonat dhe të djalit Th***, duke mbuluar shpenzimet e udhëtimit të saj (bileta avioni), si dhe 1,600 paund nga të ardhurat e vetë vajzës me fillimin e punës.*

Bashkëngjitur ju paraqes provat përkatëse”.

13.6 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me shpenzimet e kryera nga subjekti për jetesën dhe shkollimin e fëmijëve, të cilat janë llogaritur në analizën financiare.

14. Të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. V. Q., nga aktiviteti tregtar

14.1 Të ardhurat nga aktiviteti tregtar privat i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në periudhën 1994 – 2013 janë deklaruar nga subjekti në shumën 16,000,000 lekë.

14.2 Gjatë hetimit administrativ, provat dokumentare që konfirmojnë të ardhurat e deklaruara dhe ligjshmërinë e tyre nuk mbulojnë të gjithë shumën e pretenduar, prandaj ligjshmëria e një pjese të të ardhurave, si dhe saktësia e deklaramit ishte objekt vlerësimi nga Komisioni.

14.3 Subjektit të rivlerësimit iu kërkua gjatë hetimit të siguronte dokumentacion plotësues për dokumentacionin e paraqitur, të cilat nuk u vunë në dispozicion, me përjashtim të disa

vërtetimeve në lidhje me pagesën e tatimeve për biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar, për periudhën 2000 – 2005.

- 14.4** Për sa i përket vitit 1994, sipas përgjigjes nr. *** prot., datë 26.5.2020, deklarohet se për këtë vit figuron i regjistruar me nr. fiskal ***** me aktivitet “tregti me pakicë”, me xhiro gjithsej në shumën 174,469 lekë. Sipas dokumenteve bashkëngjitur kësaj shkrese janë shlyer edhe detyrimet tatimore për këtë vit. Mbi xhiron e këtij viti është aplikuar marzh fitimi në masën 40 %.
- 14.5** Për sa i përket periudhës 2007 – 2013, të ardhurat nga biznesi i Personit Fizik “V. Q.” janë marrë nga dokumentacioni i dërguar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4.
- 14.6** Dokumenti i paraqitur është në formën e vërtetimit nr. *** prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Sarandë, ku theksohet se për periudhën 13.3.2007 – 31.12.2013 z. V. Q., me NIPT *****, ka likuiduar rregullisht detyrimet fiskale të cilat janë llogaritur bazuar në deklaratimet e tij të xhiros. Bashkëngjitur janë deklaratimet e Personit Fizik për xhirot e parashikuara ose faktike të këtyre viteve. Përrjashtim bën viti 2009, në të cilin mungon ky deklaratim dhe llogaritja e detyrimeve të këtij viti është bërë për një xhiro deri në shumën 2,000,000 lekë.
- 14.7** Sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar për këtë subjekt Person Fizik, fusha e veprimtarisë së biznesit ka qenë “tregti me pakicë në dyqane jo të specializuara, pa mbizotërim artikujsh ushqimorë, pije dhe duhan”.
- 14.8** Mbi xhiron e këtyre viteve është aplikuar nga Komisioni një marzh fitimi në masën 40% për të nxjerrë fitimin e secilit vit.
- 14.9** Për më tepër, shihni metodologjinë në vijim të këtij vendimi lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit.
- 14.10** Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti për periudhën 1994 – 2013, në vlerën 16,000,000 lekë.
- 14.11** Për gjetjen e mësipërme subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
- 14.12** Në përgjigje të rezultateve, subjekti paraqiti shpjegime lidhur me të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 1994 – 2013.
- 14.13** Komisioni, pas vlerësimit të tij, mori në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe të ardhurat e bashkëshortit për periudhën 1994 – 2013, duke i llogaritur me marzhin e fitimit në masën 50 % të xhiros së aktivitetit të bashkëshortit. Kjo u reflektua edhe në analizën financiare të hartuar në vijim në pikën 15 në vijim të vendimit.

15. Analiza financiare

- 15.1** Bazuar në analizën financiare, subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditetit dhe shpenzimet e kryera, si dhe blerjet e pasurive. Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për vitet 2003 – 2016, në shumën 16,554,035 lekë.
- 15.2** Për gjetjen e mësipërme, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

- 15.3** Në përgjigje të rezultateve, subjekti solli shpjegime²⁴ lidhur me analizën financiare dhe mundësitë financiare, si dhe burimet e ligjshme për krijimin e pasurive.
- 15.4** Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit, hartoi analizën financiare përfundimtare. Shpjegimet lidhur me hartimin e kësaj analize financiare janë pasqyruar në vijim.

²⁴ Shihni shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

16.1 Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. **Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur**, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga “R** Bank”, “C** Bank”, “A** Bank”, “E** Bank”, “A** Bank”, ish-“S** Bank”, “I** S** Bank”, “B** Bank”, “L** Bank”, “E** Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. **Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:**

- i. Të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë (1994 – 2000), Gjykatën e Apelit Gjirokastrë (2000 – 2013), si dhe Gjykatën e Apelit Tiranë (2013 – 2016).
- ii. Të ardhurat nga aktiviteti privat (1994 – 2013), si dhe nga pagat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të subjekti “B*** A*** P***” (2005 – 2006) dhe të Bashkia Tiranë (2014 – 2016).

Për sa i përket aktivitetit privat të bashkëshortit të subjektit, z. V. Q., informacioni i nevojshëm për llogaritjen e saktë të të ardhurave nga ky aktivitet nuk është i plotë ndër vite.

Për vitin 1994, të ardhurat nga aktiviteti bazohen mbi xhiron e vërtetuar nga organet tatimore në vlerën 174,469 lekë²⁵.

Për vitet 1995 – 1999 xhiroja vjetore e marrë parasysht në llogaritjen e të ardhurave të ligjshme është marrë në vlerën 2,000,000 lekë.

Për vitin 2000 nga certifikata e regjistrimit vërtetohet në organin tatimor Person Fizik, veprimtari ekonomike që fillon në datën 1.3.2000 dhe vetë z. V. Q. ka deklaruar një xhiro prej 1,200,000 lekësh për periudhën 1.4.2000 – 31.12.2000 në deklaratën parashikuese të datës 28.3.2000, në DRT-në Sarandë. Nga kartela për tatimin mbi të ardhurat për z. V. Q., tregti me shumicë, vërtetohet pagesa e taksës vendore të biznesit të vogël (TVBV) sipas legjislacionit tatimor në fuqi të asaj kohe, kështu që xhiroja për atë vit është marrë në shumën 1,200,000 lekë.

Për vitin 2001 nga certifikata e regjistrimit vërtetohet në organin tatimor biznes i vogël me aktivitet “tregti me pakicë, dyqan”, me veprimtari ekonomike që fillon në datën 11.4.2001 deri më 31.12.2001, në Gjirokastrë. Sipas një fletënjoftim tatimi të DRT-së Gjirokastrë, me datë 11.4.2001, vërtetohet pagesë e një pjese të taksës vendore të biznesit të vogël (TVBV) në vlerën 10,000 lekë nga detyrimi total prej 30,000 lekësh. Ky detyrim duhej paguar për biznesin e vogël me aktivitet “tregti me pakicë”, me xhiro 0 – 2,000,000 lekë. Në analizën financiare xhiroja e marrë në llogaritje është 1,500,000 lekë (2,000,000 lekë * 9/12) sepse detyrimi prej 30,000 lekësh për taksën vendore të biznesit të vogël i përket kategorisë së biznesit “tregti me pakicë” në këtë qytet.

Për vitin 2002 xhiroja vjetore e marrë parasysht në llogaritjen e të ardhurave të ligjshme është marrë në vlerën 2,000,000 lekë.

Për vitet 2003 – 2005 dokumentohen disa pagesa bankare të taksës vendore të biznesit të vogël (TVBV), si dhe disa pagesa bankare të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Në analizën financiare, xhiroja e marrë në llogaritje është në vlerën 2,000,000 lekë, duke parë vlerat e paguara të detyrimit.

²⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2020, të DRT-së Sarandë, në përgjigjet e pyetësorit.

Për vitet 2007 – 2013 nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Sarandë, vërtetohet se për aktivitetin e tregtisë me pakicë, gjatë periudhës 13.3.2007 – 31.12.2013 janë likuiduar rregullisht detyrimet fiskale të cilat janë llogaritur bazuar në deklaratimet e xhiros nga z. V. Q., me NIPT *****. Xhirot e marra në llogaritje në analizën financiare janë marrë nga deklaratat e z.V. Q. në deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor. Në ato vite kur është deklaruar qarkullimi vjetor faktik, kjo gjë është marrë parasysh. Në mungesë të kësaj të fundit është marrë parasysh qarkullimi vjetor i parashikuar.

Për ato vite, për të cilat nuk vërtetohet xhiroja e saktë, Komisioni krijoi bindjen e realizimit të xhiros vjetore në masën 2,000,000 lekë, duke u bazuar edhe në vitet e tjera për të cilat është paraqitur dokumentacion, si dhe duke marrë parasysh edhe pamundësinë objektive të subjektit për të paraqitur akte të tjera shkruese për llogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit pa ndërprerje për periudhën 1994 – 2013.

Për secilin nga këto vite është zbatuar një normë fitimi prej 50 % mbi xhiron vjetore dhe kjo është përdorur në analizën financiare si e ardhur nga aktiviteti privat për bashkëshortin e subjektit.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura nga emigracioni në Greqi për periudhën shtator 1992 – maj 1994, në shumën 3,000,000 dhrahmi. Nuk vërtetohen këto të ardhura, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore, të pretenduara nga subjekti. Si rrjedhim, nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursim në shumën 3,000,000 lireta italiane, nga bursa e përfituar në Universitetin Politeknik të Torinos, Itali, nga bashkëshorti, i cili ka kryer studime pasuniversitare. Komisioni nuk i përfshin këto të ardhura në analizën financiare pasi nuk janë provuar nga subjekti si të ardhura (kursime) sepse janë përfituar në formën e bursës.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura në shumën 4,700 euro nga shitje kuotash të shoqërisë “B** A** P**” sipas kontratës nr. *****, datë 9.5.2006. Nuk vërtetohet me dokumentacion të plotë as burimi dhe as marrja e këtyre të ardhurave nga kjo shoqëri. Në kontratën e shitjes së kuotave (10 %), që zotëronte z. V. Q. në këtë shoqëri, nuk citohet vlera 4,700 euro, e pretenduar nga subjekti. Ekziston vetëm një shkruesë e thjeshtë me shkrim dore, e cila nuk përbën provë ligjore. Komisioni nuk e përfshin këtë vlerë si të ardhur të ligjshme në analizën financiare.

- iii. Të ardhurat nga bursa e studimeve në Greqi (2008 – 2014) dhe nga puna e vajzës M. Q. në praktikën profesionale në spital, Athinë (2012), si dhe tek “ITH Pharma Ltd UK” (2016).
- iv. Të ardhurat nga puna e djalit Th. Q. në Greqi (2016).
- v. Të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 1998 dhe shitja e apartamentit në Sarandë në vitin 2010.
- vi. Të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen” në vitin 2004, si dhe shitja e automjetit tip “Ford” në vitin 2013.
- vii. Të ardhurat nga shitja e objekt + truall në ***** në vitin 2013.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i. shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas përbërjes familjare (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT), bashkëngjitur shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2019, e ILDKPKI-së;
- ii. shpenzimet e interesit për kredinë në shumën 500,000 lekë në ish-Bankën Popullore (2005 – 2006), si dhe shpenzimet e interesit për kredinë prej 300,000 lekësh në këtë bankë (2009);
- iii. shpenzimet e qirasë për objektin në *** (2008 – 2009), shpenzimet e qirasë në Gjirokastrë (2000 – 2013), si dhe shpenzimet e qirasë së fëmijëve në Greqi (2008 – 2016), të deklaruara nga subjekti;
- iv. shpenzimi për shoqërinë “B** A** P**” (2005), i deklaruar nga subjekti në pyetësor;
- v. shpenzimi i shumës së përfituar nga shitja e truallit me sip. 387 m² në vitin 2006;
- vi. shpenzimet e masterit për subjektin në universitetin “Justiniani I” (2010 – 2011);
- vii. shpenzimet e arredimit të apartamentit në rrugën “*****” në Tiranë (2004, 2005, 2009 dhe 2013), si dhe shpenzimet e arredimit të apartamentit në Sarandë (2010, 2013 dhe 2014) të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit;
- viii. shpenzimet e tatimit për shitje apartamenti në Sarandë (2010) dhe shpenzime rivlerësimi të pasurisë objekt + truall në ***** (2013);
- ix. shpenzimet mjekësore për z. V. Q. në Greqi (2012), të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit;
- x. shpenzimi i shumës së përfituar nga shitja e pasurisë objekt + truall në **** dhe automjetit tip “Ford” në vitin 2013;
- xi. shpenzimet e arsimimit dhe jetesës për fëmijët në Greqi (2008 – 2016) dhe Mbretërinë e Bashkuar (2015 – 2016), të deklaruara nga subjekti;
- xii. në vitin 2004 vlera 11,400 euro (konvertuar në 1,444,836 lekë) është trajtuar si ndryshim (zvogëlim) likuiditeti. Nga kjo vlerë pjesa prej 700,000 lekësh është paguar për këstin e fundit të blerjes së apartamentit, ndërsa diferenca prej 744,836 lekësh është konsideruar si shpenzim në analizën financiare;
- xiii. shpenzimet e udhëtimit.

Metodologjia për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit është bërë duke iu referuar vendimit nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për subjektin E. I.

Në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor të familjarët e subjektit/bashkëshortit, nuk llogariten shpenzime qëndrimi. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar dhe dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive²⁶.

16.2 Për sa më sipër, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë e krijuara, nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

²⁶ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

1. Në vlerësimin tërësor të çështjes mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se:
2. Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit, për arsye se:
3. Për apartamentin 2+1 në rrugën “*****”, Tiranë:
 - Subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
 - Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme²⁷ për blerjen e këtij apartamenti, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
 - Subjekti ka kryer veprime (për përfitimin e pronësisë, veprime duke u hequr si pronare e pasurisë pa përfituar titullin dhe veprime të shkëmbimit të pronës, duke shmangur ligjin dhe detyrimet në buxhetin e shtetit) që bien ndesh me etikën e saj si gjyqtare.
4. Për truallin në fshatin Finiq, Delvinë, blerë në vitin 2002, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2003, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
5. Për objektin lokal shërbimi në Sarandë, blerë në vitin 2007, në vlerën 1,980,000 lekë:
 - Subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
 - Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1,850,000 lekë për blerjen e kësaj pasurie, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
 - Subjekti ka kryer veprime (për përftimin e pronësisë, veprime duke u hequr si pronare e pasurisë pa përfituar titullin dhe veprime të shkëmbimit të pronës, duke shmangur ligjin dhe detyrimet në buxhetin e shtetit) që bien ndesh me etikën e saj si gjyqtare.
6. Në lidhje me sipërfaqen e truallit në Sarandë, blerë në vitin 2005, në bashkëpronësi, në vlerën 240,000 lekë, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 813,683 lekë, duke u gjendur brenda parashikimeve germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
7. Për apartamentin 2+1 në Sarandë, blerë në vitin 2012, në vlerën 6,277,504 lekë + 2 garazhe, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të pamjaftueshëm, nuk ka deklaruar pasurinë garazh në DPV-në e viteve 2012 - 2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme²⁸, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

²⁷ Shihni analizën financiare në pikën 1.26 të këtij vendimi.

²⁸ Shihni pikën 6 të këtij vendimi.

8. Për depozitën në vlerën 5,600 euro në “R** Bank”, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
9. Për depozitën në vlerën 5,002 euro në “I** S** Bank”, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
10. Për depozitën në vlerën 5,006 euro në N**Bank, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
11. Analiza financiare për vitet 2003 dhe 2016, bazuar në të cilën rezultuan balanca negative vjetore për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive, si vijon:
 - për vitin 2006 rezultoi me një balancë negative në shumën 1,607,671 lekë;
 - për vitin 2007 rezultoi me një balancë negative në shumën 1,764,693 lekë;
 - për vitin 2009 rezultoi me një balancë negative në shumën 1,192,741 lekë;
 - për vitin 2010 rezultoi me një balancë negative në shumën 1,037,637 lekë;
 - për vitin 2011 rezultoi me një balancë negative në shumën 216,025 lekë;
 - për vitin 2013 rezultoi me një balancë negative në shumën 695,450 lekë;
 - për vitin 2015 rezultoi me një balancë negative në shumën 3,105,390 lekë.
12. Pra, subjekti ka pamundësi financiare për blerjen e pasurive për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në shumën -9,619,607 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
13. Në përfundim Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasuritë e krijuara nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre duke zbritur dhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.
14. Duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësimin e kushteve të parashikuara nga pika 1 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e cila parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur”,* ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë pasuritë në pronësi.

Pika 3 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”,* ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të përmendura në këtë vendim.

Pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: *“Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”,* ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe në përdorim të tij dhe është përpjekur të fshehtë këto pasuri.

Subjekti nuk gjendet në kushtet e germës “a”, por gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15. Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave private, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe bashkëpronësi. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.
16. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato *cash*) dhe kryerjen e shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtare.
17. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
18. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe veprime që bien ndesh me detyrën dhe funksionin e saj si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton nga vlerësimi në tërësi i kriterit të pasurisë dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura pas një vlerësimi tërësor të procedurave lidhur me kriterin e pasurisë, sipas nenit 4, paragrafi 2, të ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Maria Qirjazi, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.2.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Roland ILIA
Relator

Gledis Hajdini
Sekretare gjyqësore